

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(457)

GUSHT 2026

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtör: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI


SHQIPËRI-
GJERMANI,
PARTNERITET
I GJATË DHE I
NGUSHTË
USHTARAK



FAQE 3

PROMOVIMI

GJENERAL
ISMAIL
SHULKU, MES
UNIFORMËS,
FAMILJES DHE
KUJTESËS



FAQE 6

PROFILI

PROF. DR. BERNARD ZOTAJ - NJË JETË
NË SHËRBIM TË HISTORISË, DIJES DHE
KUJTESËS KOMBËTARE



Nga Agim LIKA Poet, historian dhe studiues

FAQE 8

90 - VJETORI I DITËLINDJES/ Mirënjohje për mësuesin, historianin dhe etnologun e shquar, nga Shoqatat "Labëria", "Sofra pukjane", "Eko Turizmi" Pukë dhe "Malzju"

PROF. XHEMAL MEÇI "NDERI DHE KRENARIA" E OBVL

REFERATI

KORIFEU I DIJES QË E
SHNDËRROI
HISTORINË NË
KUJTESË
TË GJALLË TË KOMBIT

FAQE 7

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

PERSONAZH

DERVISH HIMA DHE
ZENEPE HIMA (QOKU),
KONTRIBUT MADHOR
PËR CËSHTJEN
KOMBËTARE DHE
GJUHËN SHQIPE

Nga Sakip Cami

FAQE 12

OPINION

PARA SE TË FLISNI PËR
SPASTRIME ETNIKE,
KËRKONI
FALJE PËR KRIMET
KUNDËR NJERËZIMIT

Nga Nexhbedin Basha

FAQE 4



• Vepra e tij studimore-shkencore e publicistike e rendit me
elitën krijuese të kombit, si simbol i dijes, përkushtimit qytet-
ar, paqes dhe dashurisë njerëzore

FAQE 16

IN MEMORIAM

NJË ALBUM ME VEPRËN DHE SHPIRTIN E PIKTORIT MUSA QARRI
SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14

REAGIMI



FAQE 5

Kryesia e OBVL dënon më ashpërsi deklaratën
shokuese të çmendurës së Beogradit zyrtar Paunović

KOSOVA SHTET I LIRË
DHE SOVRAN, REALITET
I PAKTHYESHËM

• TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU:
OBVL vlerëson se UÇK është simboli i
rezistencës për mbrojtjen e trojeve etnike
shqiptare. Bashkë me mbështetjen e NA-
TO-s çliruan njëherë e përgjithmonë tokën
ilire të Kosovës

FAQE 15

82 VJETORI

RRUGA E
LAVDISHME E
BRIGADAVE TË 18-TË
DHE 19-TË S
PARTIZANE

FAQE 11

NDERIMI

BOROVA, LABËRIA,
SHQIPTARIA
PËRBALLË
MASAKRAVE GJATË
LANÇ-IT

Prof. Asoc. Dr. ZAHO GOLEMI

FAQE 2

82 VJETORI I RËNIES

MUSTAFA GJINISHI –
KOMISARI I PARË I
ÇETËS PARTIZANE TË
PEZËS

Prof. Asoc. Dr.
Bernard Zotaj

FAQE 10

PESONALITETE TË ARSIMIT

MËSUESI I
POPULLIT, SELIM
ALLIU

Mësuesi i Popullit, Selim Alliu

FAQE 13

NDERIMI

BOROVA, LABËRIA, SHQIPTARIA PËRBALLË MASAKRAVE GJATË LANÇ-it



Prof. Asoc. Dr. ZAHO GOLEMI

Gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe periudhave të mëparshme, Borova, Labëria dhe mbarë shqiptaria në jug dhe në veri përjetoi disa masakra të kryera nga pushtuesit nazifashistë, por dhe bashkëpunëtorët e tyre. Një prej më të njohurat është Masakra e Borovës dhe një zinxhir masakrash përreth saj si në Kagjinas, Podë, Barmash, por masakra të njohura kanë ndodhur në Vranisht, Vajzë, lufinën e Lumit të Vlorës, në Dibër, Mat et. Në Dimrin 1943-1944 nazistet ndërmorën një operacion ndëshkues në Mesaplik të koduar "Bergkessel" (Kazani Malor), për të asgjësuar forcat partizane që ishin dislokuar në këtë gryke. Në Vranisht, më 18.12.1943, ata ndeshen në një rezistence, si rezultat i se cilës pësuan humbje të rënda në kufi me Tërbaçinm në shesh të Mesit, aty ku rruga gjarpëron për në Kallarat. Ndëshkimi vijoi dhe në fazën e dytë të Operacionit të koduar "Harriroh" (Thirrja për ta çuar gjahun), më 9 dhe 10.2.1944.

Në Vranisht më 10.2.1944 forcat gjermane ndërmorën operacione ndëshkimore, duke vrarë banorë të fshatit dhe duke djegur shtëpi. Viktimat ishin kryesisht civilë, përfshirë burra, gra dhe të moshuar dhe më konkretisht: Pa asnjë armatim personal e asnjë mbështetje, ranë nën breshëritë e plumbave: Azbi Ramadani, Sali Xhama, Zeqir e Shaban Llanaj, Hamit Lamaj, Hajro Çino, Razi Shyti, Sinan Xhama, Dervish Caraj, Arap Janushi, Faik Janushi, Demir e Mersin Zoto, Arshi Xhebraj, Dino Bajrami, Rakip Duka, Ahmet Demo, Ymer Basho, Faik Shakaj, Merçan Shakaj, Ahmet Xhebraj, Yzeir Kongjoni, Nazer Premtaj, Halim Karroqaj, Sulejman Limaj, Osman Tartari, Avdi Ismaili, Mingo Bajrami dhe Ariz Varfi.

Në fshatin Vajzë të Vlorës gjatë periudhës 1943 dhe dimrin e 1944 forcat pushtuese kryen ekzekutime të banorëve të dyshuar për mbështetje të lëvizjes antifashiste si: Ferik Zagoll Bilbilaj, Dalan Mehmet Kamberaj, Këze Sulçaj, Pesare Kërroçaj, Beqir Beqar Osmani, Abdyl Beqar Osmani, Shaho Barjam Selimaj, Delo Mystehak Sulçaj, Sadedin Sherif Hazizi, Azbi Nurçe Hitaj.

Në Kuç Të Vlorës gjatë operacioneve gjermane në vitin 1943 e 1944, u vranë banorë dhe u dogjën banesa të shumta ku viktimat ishin civilë dhe mbështetës të rezistencës së luftës partizane. Në fshatin Bolenë, fshati u godit gjatë operacioneve ndëshkimore gjermane, me

Në nderim të popullsisë shqiptare që humbi jetën nën breshëritë e plumbave të nazifashistëve italo-gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore; në nderim të jetëve të humbura dhe gjakut të derdhur për lirinë në Borovë, Barmash, Kagjinas, Podë, Vranisht, Vajzë, Kuç, Bolenë, Mallakastër, Pezë, Dibër, Skrapar, Mat, Dukaj të Tepelenës, etj. Masakrat çnjerëzore nazifashiste duhet të përkujtohen që historia të mos përsëritet...



viktima në radhët e popullsisë civile dhe dëme të mëdha materiale. Këto masakra kishin si objektiv frikësimin e popullsisë së Labërisë dhe shtypjen e rezistencës antifashiste. Viktimat ishin kryesisht civilë të pafajshëm, por edhe luftëtarë të rezistencës të kapur nga forcat pushtuese. Në Borovë (6 korrik 1943) ka ndodhur një ndër masakrat më të rënda në Shqipëri.

Forcat gjermane vranë 107 banorë, mes tyre gra, fëmijë dhe të moshuar nga 4 muajsh deri në 84 vjeç, dhe dogjën fshatin. Në Borovë u ekzekutuan: Venetija Thoma Toti, Koço Thoma Tota, Aleko Ngjelo, Zoica Totoni, Kristina Ilija Andon, Ilija Andon, Parako Andon, Stefani Peti Andrea, Vasiliqi Peti Andrea, Andronika Peti Andrea, Marija Koli Proko, Konstandin Ilija, Andronika Ilija, Nikolla Ilija, Eftali Pando Tota, Poliksen Pando, Sotir Petro Zoto, Afrovit Pilo, Sotir Taque, Sotir Petro, Kleanthi Janaq, Mariko Janaq, Sofia Janaq, Ilija Janaq, Anastas Simoni, Maria Anastas, Josif Mingo, Dhimitro Josif, Aleksandra Pali, Lirika Pali, Pando Josif, Akondisa Mingo, Telo Jani, Vasillaq Llambi, Maria Stefan, Androniqi Kozma, Ksanthip Kozma, Dhevgjenia Kozma, Ollga Kozma, Paskal Kozma, Arqimandrit Grigor, Ollga Thoma, Piro Thoma, Taqi Thoma, Anastasi Thanas, Koço Thanas, Dhoksia Mikel, Dhimitrulla Vangel, Mërtiro Thanas, Mihal Petro, Eftalia Mihal, Jane Aleks, Afrovit Lula, Sotiraq Lula, Aleks Lula, Fillareta Lula, Stefano Thoma, Eftalia Thoma, Dhora Thoma, Urani Thoma, Aleks Serafim, Jorgji Kristo, Spiro Jorgji, Afrivit Jorgji, Thoma Kondaku, Serafim Kuke, Eftalia Lani, Ollga Lani, Stefano Sokrat, Viktoria Sokrat, Gjergo Sokrat, Josif Pano, Katerina Pando, Katerina Stefan, Efthimia Koço, Josif Buzi, Vasil Anastas, Katerina Josif, Mitro Mihal, Llambi Vasil, Evgjeni Vasil, Koço Llambi, Theodhora Llambi, Vasiliqi Ilija, Gaqi Josif, Polikroni Josif, Evanthe

Gaqi, Pali Gaqi, Josof Gaqi, Paravi Gaqi, Andronika Gaqi, Peti Sino, Katerina Peti, Sofia Peti, Dhimitri Peti, Simo Peti, Thomaidha Peti, Katerina Sotir, Marianthi Sotir, Polikron Sotir, Vesel Gage, Eleni Lazi, Thomaidha Lazi, Miço, Pilo Konioni, Zoga Punde, Perikli Zhuku, dhe (107) Poliksen Vasil. Fakt është që të ekzekutuarit në Borovë janë shpallur pas 79 vitesh me titullin dëshmor. Po të ekzekutuarit e tjerë ende presin të drejtën historike. Në fshatit Kagjinas të Ersekës dhanë jetën në masakrën e famshme të 11 korrikut 1943: Jemin Hamdiu, Abedin Nuke, Avni Ismail Skënderi-Frashëri, Fejzi Rasip Kapo, ish-partizan i batalionit "Hakmarra", i cili kishte shkuar me leje për disa ditë në Kagjinas, Muharrem Rasip Kapo, Mehmet Halim Hamdiu, Sadik Tela Hamdiu, Safet Myrteza Hamdiu, Shyqyri Sali Bahollari, Sali Shyqyri Bahollari, Muhamet Ali Tare dhe Teko Ramo Ferhati.

Masakra në Mallakastër është kryer gjatë gjatë operacioneve gjermane të viteve 1943 dhe 1944 u dogjën shumë fshatra dhe u vranë dhjetëra civilë të dyshuar se mbështesnin rezistencën. Në Pezë dhe trevën përreth saj forcat italiane dhe gjermane ndërmorën operacione ku u vranë banorë dhe u shkatërruan banesa për shkak të veprimtarisë së rezistencës. Në trevën dibrane që ishte një ndër vatrat prush të ndezura antifashiste gjatë ofensivave gjermane të vitit 1944, shumë fshatra u dogjën dhe dhjetëra civilë u ekzekutuan. Gjithashtu edhe në Skrapar operacionet naziste gjermane të vitit 1944 sollën vrasje të civilëve, djegie fshatrash dhe shkatërrime të mëdha. Po kështu edhe në disa fshatra të Matit u kryen ekzekutime dhe djegie gjatë operacioneve kundër forcave partizane.

Viktimat e masakrave ishin civilë të pafajshëm, fëmijë, gra, burra e të moshuar, si edhe luftëtarë të rezistencës të kapur. Shumë fshatra u dogjën plotësisht

dhe popullsia u detyrua të largohej nga banesat e saj. Duhet thënë se Borova, por dhe fshatrat përreth (sepse ishte një zinxhir masakras përreth Borovës) dhe sidomos Kagjinasi fshati i Avni Skënder Frashëri mbetet shembulli më i njohur dhe më tragjik i masakrave të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Dhjetra masakra të tjera kanë ndodhur në të gjithë Shqipërinë. Ligji nr. 109/2018 flet qartë për ekzekutimet nazifashiste që të gjithë që u ekzekutuan dhe ranë nën breshërinë e plumbave fashiste meritojnë të shpalen me titullin "Dëshmor i Atdheut". E drejta vonon, por nuk harron, thotë një maksimum popullor. Vetëm një pjesë e të ekzekutuarve e "kanë gjetur të drejtën" përmes të gjallëve, por shumica ende janë në pritje edhe pse kanë mbi tetëdhjetë vjet që quhen "viktima", kur ligji i njeh "dëshmorë". Le të sjellim një shembull. Dymbëdhjetë të ekzekutuar në Kagjinas vetëm dy janë shpallur dëshmorë, ndërta Avni Skënderi, Fejzi Kapo, Muharrem Kapo, Mehmet Hamdiu, Sadik Hamdiu, Safet Hamdiu, Shyqyri Bahollari, Sali Bahollari, Muhamet Tare dhe Teko Ferhati, presin dokumentacionin dhe Këshillat Bashkiakë, Prefekturat, Këshillat e qarikut e deri tek Komisioni Qendror qeveritar në Tiranë. Është një e drejtë që duhet t'i kujtojë aktorët e faktorët e pushtetit vendor e qendror, të cilëve ligji u ka dhënë kompetenca për zbatimin e tij. Është koha për ta zbatuar me përpikëri këtë ligj të shenjtë për Dëshmorët e Atdheut. Plagët e përgjakura të historisë me masakrat çnjerëzore nuk mbyllen kurrë, por le të lehtësohen dhimbjet dhe kujtesa të jetojë përgjithmonë, që historia të mos përsëritet. Shqiptarët gjatë LANÇ-it me gjakun e tyre shkruan pavdekësinë në altarin e kombit shqiptar, por të ekzekutuarit në luftë jo vetëm që duhet të përkujtohen por edhe të shpallen me titullin e merituar Dëshmorët e Atdheut.

VIZITA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH gjenerallejtënant Arben Kingji: Gjermania është një aleate e besueshme dhe një partnere shumë e çmuar

Shqipëri - Gjermani, partneritet i gjatë dhe i ngushtë ushtarak

15 korrik 2026 - Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjenerallejtënant Arben Kingji, mirëpriti në një vizitë zyrtare shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Gjermane, gjeneral Carsten Breuer. Vizita konfirmon nivelin e lartë të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë, si aleate në NATO, si edhe angazhimin e përbashkët për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë takimit zyrtar, gjenerallejtënant Kingji njohu homologun e tij mbi zhvillimet më të fundit të Forcave të Armatosura, me fokus në prioritetet kryesore të zhvillimit të kapitalit njerëzor, forcimit të sistemit të arsimit dhe edukimit ushtarak, modernizimin e kapaciteteve dhe rritjes së ndërveprueshmërisë me aleatët.

Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Kingji shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin më të lartë për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë vendit tonë, si në procesin e integritetit evropian, ashtu edhe në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes. Ai vlerësoi kontributin e çmuar të Gjermanisë ndaj Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në fushën e arsimit dhe edukimit ushtarak, stërvitjeve, zhvillimit të kapaciteteve dhe rritjes së ndërveprueshmërisë me aleatët. Ky partneritet i vyer ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e gatishmërisë, profesionalizmit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura dhe mbetet një shtyllë e rëndësishme e bashkëpunimit tonë strategjik dhe e angazhimit të përbashkët për sigurinë dhe stabilitetin rajonal e euroatlantik.

Nga ana e tij, gjeneral Breuer u shpreh se "Gjermaninë dhe Shqipërinë i lidh një partneritet i gjatë dhe i ngushtë ushtarak. Që nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në vitin 2009, ky partneritet është forcuar vazhdimisht. Sot ai është më i rëndësishëm se kurrë. Shqipëria është një aleate e besueshme. Sidomos në situatën aktuale të sigurisë, besueshmëria ka një rëndësi vendimtare. Nuk është madhësia e forcave të armatosura ajo që përcakton vlerën e një aleati. Vendimtare janë gatishmëria operacionale, besueshmëria dhe kontributi konkret për sigurinë tonë të përbashkët. Pikërisht këto vlera përfaqëson Shqipëria.

Dy shefat e Shtabit biseduan mbi zhvillimet në mjedisin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare, duke vlerësuar se sfidat aktuale, nga konfliktet konvencionale te kërcënimet hibride dhe ato kibernetike kërkojnë koordinim më të madh, investime të qëndrueshme në mbrojtje dhe forcim të mëtejshëm të gatishmërisë së Aleancës. Palët rikonfirmuan rëndësinë strategjike të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Gjenerallejtënant Kingji vuri theksin në angazhimin e Shqipërisë për të kontribuar në forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive në kuadër të NATO-s.

Në kuadër të vizitës zyrtare, gjeneral Carsten Breuer mbajti një fjalim për kursantët dhe stafin akademik të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, stafin akademik të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe të ftuar të tjerë në radhët e Forcave të Armatosura.

Në fjalën e tij të mirëseardhjes, gen-



erallejtënant Kingji vlerësoi praninë dhe lidhshëpin e homologut gjerman, duke theksuar rëndësinë e partneritetit strategjik ndërmjet dy vendeve.

"Gjermania është një aleate e besueshme dhe një partnere shumë e çmuar. Si një nga aleatët kryesorë evropianë të NATO-s, ajo jep një kontribut thelbësor në mbrojtjen kolektive, shkurrësimin dhe rritjen e gatishmërisë së Aleancës. Ne e vlerësojmë lart mbështetjen që Gjermania i ka dhënë Forcave të Armatosura të Shqipërisë në fushën e arsimit profesional ushtarak, stërvitjes, ushtrimeve të përbashkëta dhe zhvillimit të kapaciteteve. Ky bashkëpunim forcon gatishmërinë tonë, rrit ndërveprueshmërinë dhe mbi të gjitha, kontribuon në formimin e liderëve që do të udhëheqin Forcat tona të Armatosura në të ardhmen. Njëkohësisht, Shqipëria mbetet një kontribuuese aktive në operacionet e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, duke dhënë një kontribut të vazhdueshëm për sigurinë kolektive dhe stabilitetin rajonal."

Në fjalën e tij para audiencës, gjeneral Breuer theksoi se "Shqipëria luan një rol të rëndësishëm si faktor stabiliteti në Evropën Juglindore. Si një aleate e qëndrueshme, e besueshme dhe plotësisht e integruar në NATO, Shqipëria forcon rajonin, Aleancën dhe, në këtë mënyrë, sigurinë evropiane. Pikërisht për këtë arsye dialogu dhe bashkëpunimi ynë kanë një rëndësi të veçantë. Ky bashkëpunim duhet të mbështetet në kërkesa konkrete ushtarake dhe të sjellë rezultate të prekshme. Objektivi ynë i përbashkët është i qartë: të forcojmë shtyllën evropiane të NATO-s – përmes unitetit, forcimit të kapaciteteve ushtarake, kontributeve konkrete ushtarake dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet aleatëve, partnerëve dhe miqve të besueshëm."

Gjatë axhendës së vizitës së tij, gjeneral Breuer u prit në një takim zyrtar nga Ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi.

GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: PROJEKTET TONA TË MODERNIZIMIT SYNOJNË KAPACITETE KONKRETE

Në konferencën e përbashkët për shtyp me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Republikës Federale të Gjermanisë, Gjeneral Carsten Breuer, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH gjenerallejtënant Arben Kingji, pasi falenderoi homologun gjerman për vizitën tuaj këtu, dhe për dialogun e hapur e konstruktiv që zhvilluan, mbajti deklaratën e mëposhtme:

- *Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjenerallejtënant Arben Kingji mirëpriti në një vizitë zyrtare homologun e tij gjerman, gjeneral Carsten Breuer...*
- *Gjatë axhendës së vizitës së tij, gjeneral Breuer u prit në një takim zyrtar nga Ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi...*

"Bashkëpunimi ushtarak ndërmjet Forcave tona të Armatosura ka filluar në vitet 90', me një mbështetje të konsiderueshme të palës gjermane në fushën e arsimit, stërvitjeve, por edhe angazhim të përbashkët në operacione dhe misione, të cilat kanë kontribuar në rritjen e profesionalizmit, ndërveprueshmërisë, zhvillimit të kapaciteteve dhe gjithashtu edhe anëtarësimin tonë në NATO.

Gjatë takimit vlerësuam mjedisin e sigurisë në rajon, Europë dhe më gjerë. Ai mbetet kompleks dhe i paqëndrueshëm, i ndikuar nga konfliktet konvencionale, kërcënimet hibride dhe ato kibernetike. Në këtë kontekst, rikonfirmuam nevojën e përkushtimit dhe angazhimit tonë ndaj stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kuadër, Forcat e Armatosura të RSH kontribuojnë në mënyrë aktive në iniciativat rajonale (A-5, BCHODs, DECI, SEDM, ADRION) duke shtyrë përpara axhendën e vendit tonë të orientuar në stabilitet dhe siguri rajonale.

Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, dhe ai i BE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, ALTHEA, mbeten thelbësorë për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Forcat tona të Armatosura mbeten të angazhuara për vijimin e kontributit në të dyja këto misione. Dëshiroj të shpreh këtu mirënjohjen për rolin e rëndësishëm ndër vite të Gjermanisë në KFOR. Gjithashtu, përshëndesim vendimin e marrë nga Gjermania së fundmi, për të vijuar angazhimin ushtarak në KFOR (me deri në 400 ushtarake për t'u dislokuar nëse do



të jetë e nevojshme). Ndërkohë që vlerësojmë rolin udhëheqës të Gjermanisë në NALT, Shqipëria përshëndet mbështetjen konstante dhe të fuqishme të Gjermanisë për Institucionet e sigurisë së Kosovës dhe kalimin gradual të përgjegjësisë të sigurisë tek këto institucione.

Gjeneral Breuer, ky angazhim dhe kontribut i vijueshëm i forcave tuaja të Armatosura dhe i Gjermanisë ka ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë e Kosovës dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor.

Bashkë me gjeneral Breuer shprehëm mbështetjen tonë të fuqishme për planet e mbrojtjes së Aleancës, me qëllim sig-

urinë e të gjithë zones Euro-Atlantike.

Ne vlerësojmë përgjegjësinë në rritje të Gjermanisë në NATO. Gjermania përbën një shembull reference në NATO për kthimin e shpejtë të shpenzimeve të mbrojtjes në kapacitete ushtarake, duke udhëhequr përpjekjet evropiane në këtë drejtim.

Samiti i Ankarasë konfirmoi se besueshmëria dhe kohezioni i NATO-s përtej angazhimeve politike, do të matet me aftësinë tonë për të gjeneruar forca të gatshme, të dislokueshme dhe të ndërveprueshme.

Theksuam domosdoshmërinë që buxheti i mbrojtjes të zbatohet në mënyrë efektive për materializimin e kapaciteteve ushtarake të cilat do të kontribuojnë në realizimin e projekteve të modernizimit, objektivave të kapaciteteve dhe mbështetjes për planet rajonale të Aleancës.

Informova gjeneralin Breuer për zhvillimet dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Përpjekjet tona përqendrohen te personeli i motivuar, arsimimi cilësor, stërvitja dhe kapacitetet e ndërveprueshme.

Projektet tona të modernizimit synojnë kapacitete konkrete që i shërbejnë përmbytjes së misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, si dhe detyrimet e vendit tonë në kuadër të Aleancës. Prioritet mbeten mbrojtja ajrore, sistemet pa pilot, mbështetja me zjarr, mbrojtja kibernetike, komandim-kontrolli dhe logjistika.

Vëmendje të veçantë po i kushtojmë lëvizshmërisë ushtarake dhe kapaciteteve të mbështetjes së vendit pritës përgjatë Korridorit VIII, si nyje strategjike për lëvizjen e trupave dhe pajisjeve në drejtim të lindjes.

Të nderuar përfaqësues të medias, ju falënderoj për vëmendjen dhe interesin tuaj. Gjeneral Breuer, ju falënderoj edhe një herë për vizitën, lidhshëpin tuaj dhe kontributin e Gjermanisë për sigurinë e rajonit tonë dhe zones Euro-Atlantike.

Personalisht, mbetem i predispozuar për vijimin dhe thellimin më tej të bashkëpunimit ndërmjet forcave tona të armatosura".



REAGIMI

Deklarata e ministres serbe Snežana Paunović lidhur me shqiptarët e Kosovës nxit reagime të ashpra në Kosovë dhe Bruksel

BE DËNON RETORIKËN QË PROMOVON SPASTRIMIN ETNIK

KOS: "NË EVROPË NUK KA VEND PËR RETORIKË QË JUSTIFIKON APO GLORIFIKON SPASTRIMIN ETNIK"

Deklarata e ministres së Serbisë, Snežana Paunović, u dënua edhe nga zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian. Komisionerja për Zgjerim në BE, Marta Kos, tha në Bruksel se "në Evropë nuk ka vend për retorikë që justifikon apo glorifikon spastrimin etnik".

"Mund të ketë vetëm zero tolerancë për deklarata të tilla çfarë kemi dëgjuar. Dhe nuk ka vend në Evropë për retorikë që justifikon, avokon apo glorifikon pastrimin etnik.

Unë jam personalisht e tronditur se kjo duhet të thuhet në këtë situatë. Deklarata të tilla janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vlerat dhe dinjitetin njerëzor, pajtimin e nevojshëm, llogaridhënien dhe raportet e mira ndërfaqinësore mbi të cilat themele është ndërtuar BE-ja e pa të cilat procesi i anëtarësimit nuk mund të ndodhë", tha Marta Kos. Komisioner-

ja Marta Kos tha se ajo personalisht "supozon që kjo të jetë vetëm qëndrim personal i një ministreje e jo i Qeverisë së Serbisë".

Edhe zëdhënësja e BE-së për politikën e jashtme, Anita Hiper, tha se "deklarata të tilla janë në kundërshtim me vlerat e dinjitetit njerëzor".

"Deklaratat e tilla janë në kundërshtim me vlerat e dinjitetit njerëzor, pajtimin, llogaridhënien dhe raportet e mira ndërfaqinësore mbi të cilat është ndërtuar BE-ja. Ato shkojnë edhe kundër detyrimeve që ka marrë Serbia në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE për normalizimin e raporteve me Kosovën", tha Hiper. Ajo tha se Brukseli pret "nga të gjithë liderët që të përmbahen nga çfarëdo retorike nxitëse dhe të japin kontribut për një ambient të besimit dhe stabilitetit në rajon".

Duke folur para gazetarëve në Bruksel, zëdhënësja e Komisionit Evropian, Anitta Hipper, theksoi se në Evropë nuk ka vend për retorikë të tilla, pasi bien ndesh me dinjitetin njerëzor.

"Në Evropë nuk ka vend për re-



torikë që arsyeton ose promovon spastrimin etnik.

Deklarata të tilla bien ndesh me vlerat e dinjitetit njerëzor, pajtimin, llogaridhënien dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian", u shpreh

Hipper. Ajo nënvizoi se deklarata të tilla janë gjithashtu në kundërshtim me angazhimet që Serbia ka marrë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhëniet me Kosovën, proces që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

OPINION

PARA SE TË FLISNI PËR SPASTRIME ETNIKE, KËRKONI FALJE PËR KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT



Nga Nexhbedin Basha*

Kur dëgjova deklaratën e ministres serbe Snežana Paunović, ministre e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Serbisë, se sikur të kishte qenë në vitin 1998 do ta kishte "spastruar etnikisht Kosovën", para syve m'u shfaq si një shirit i gjatë filmik historia e dhimbshme e shqiptarëve të Kosovës.

Mendja më udhëtoi larg në shekuj, që nga Beteja e Kosovës e vitit 1389, e deri te ngjarjet më tragjike të kohëve moderne. M'u kujtuan spastrimet etnike, dëbimet, burgosjet, masakrat dhe përpjekjet e vazhdueshme për të zhdukur identitetin shqiptar në Kosovë.

M'u shfaqën vitet pas 1913-ës, kur, pas copëtimit të trojeve shqiptare, ushtria e Mbretërisë së Serbisë dogji shtëpi e ka-

tunde, vrau burra, gra e fëmijë, plaçkiti pasuritë dhe detyroi mijëra shqiptarë të merrnin rrugët e mërgimit. Shumë prej tyre gjetën strehë në Shqipëri. Edhe sot, në Tiranë, Durrës, Shijak, Fier e qytete të tjera jetojnë pasardhës të atyre familjeve kosovare që u detyruan të largoheshin nga trojet e tyre për t'i shpëtuar dhunës.

Më kujtohet pranvera e vitit 1981, kur studentët e Universitetit të Prishtinës dolën në rrugë me kërkesën "Kosova Republikë". Demonstratat u shtypën me dhunë; policia përdori gaz lotsjellës, mijëra të rinj u arrestuan, u dënuan me burgje të gjata dhe filloi një valë e represioneve ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Pastaj vijnë vitet 1998-1999, plagët më të freskëta të kujtesës sonë. Karvanët e pafund të shqiptarëve të dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre, kolonat e refugjatëve që kalonin kufirin drejt Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, fëmijët në krahët e nënave, pleqtë që ecnin në këmbë me ditë të tëra, shtëpitë e djegura, varret masive dhe mijëra viktime të pafajshme. Ishte një nga spastrimet etnike më të rënda në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, kur edhe sot një ministre e një shteti evropian shpreh nostalgji për një krim të tillë, ajo nuk fyen vetëm shqiptarët e Kosovës. Ajo fyen kujtesën e viktimave, sfidon të vërtetën historike dhe cenon vetë parimet mbi të cilat është ndërtuar Evropa moderne: paqen, dinjitetin njerëzor dhe parimin se krime të tilla nuk duhet të përsëriten kurrë.

Historia nuk mund të ndryshohet me deklarata, por deklaratat mund të helmojnë të ardhmen. Pikërisht për këtë arsye, kujtesa historike nuk është hakmarrje; është detyrim moral për të mos lejuar që tragjeditë e së kaluarës të kthehen në

realitetin e brezave që vijnë.

Më kujtohen edhe ditët e para të ekzodit. Më kujtohen dëshmitë tronditëse të dhjetëra kosovarëve që mbërritën në Kukës, të rraskapitur nga udhëtimi i detyruar, me sytë e mbushur me lot dhe me dhimbjen e lënies pas të shtëpive, familjarëve e të afërmeve. Tregonin për kolonat e gjata të dëbimit, për shtëpitë e djegura, për njerëzit e vrarë, për dhunën e ushtruar vetëm pse ishin shqiptarë.

Më pas, e gjithë Shqipëria u bë një shtëpi e madhe për ta. Në Kukës, Tiranë, Durrës, Dibër, Fier, Vlorë, Gjirokastrë e pothuajse në çdo qytet e fshat të vendit, familjet shqiptare hapën dyert dhe zemrat për vëllezërit e motrat nga Kosova. Ishte një solidaritet që do të mbetet përgjithmonë një nga faqet më të ndritura të historisë sonë kombëtare. Edhe familja ime pati fatin dhe nderin të strehojë një familje kosovare. Më kujtohet vogëlushja tetëvjeçare, Fitore, e cila, edhe pse mban-te mbi supe peshën e luftës, ruante pajësinë e fëmijërisë. Për muaj të tërë ata nuk ishin mysafirë; u bënë pjesë e familjes sonë, duke ndarë me ne sofrën, gëzimet, shqetësimet dhe shpresën se një ditë do të ktheheshin të lirë në shtëpitë e tyre. Si gazetar, më kujtohen pamjet që nuk harrohen kurrë: masakra e Reçakut, varret masive të zbuluara pas luftës, dëshmitë e të mbijetuarve, fshatrat e shkatërruar, mijëra civilë të vrarë dhe krimet që tronditën ndërgjegjen e botës. Shumë prej këtyre krimeve kundër njerëzimit ende presin drejtësi të plotë. Edhe sot, shumë familje vazhdojnë të kërkojnë fatin e të afërmeve të zhdukur, ndërsa një kërkim-falje e qartë dhe e sinqertë për vuajtjet e shkaktuara ende mungon.

Më kujtohen përpjekjet diploma-

tike të sekretares amerikane të Shtetit, Medlin Olbrajt, për të shmangur luftën dhe për të gjetur një zgjidhje paqësore. Kur ato përpjekje dështuan, ndërgjegjia demokratike e botës nuk mund të rrinte më në heshtje përballë tragjedisë që po zhvillohej në Kosovë.

Më kujtohet qëndresa heroike e Komandantit Legjendar dhe sakrificat e pothuajse të gjithë familjes Jashari në Prekaz. Ajo nuk ishte thjesht një betejë; u shndërrua në simbolin e vendosmërisë së një populli për të jetuar i lirë në trojet e veta.

Më kujtohen edhe luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët morën armët me bindjen se po mbronin popullin dhe të drejtën për liri. Proceset gjyqësore ndaj ish-drejtimesve të UÇK-së zhvillohen në institucionet ndërkombëtare dhe duhet të respektojnë parimin themelor që drejtësia të jetë e paanshme, e bazuar në prova dhe e barabartë për të gjithë. Në të njëjtën kohë, mbetet një kërkesë e ligjshme morale që edhe krimet e kryera ndaj civilëve shqiptarë të hetohen dhe autorët e tyre të mbajnë përgjegjësi.

Prandaj, kur sot dëgjoj deklarata që flasin me lehtësi për "spastrime etnike", nuk dëgjoj vetëm një fjali. Dëgjoj jehonën e një historie të mbushur me dhimbje, kujtoj fytyrat e refugjatëve, lotët e nënave, fëmijët e mbetur jetimë dhe mijëra jetë të këputura padrejtësisht. Pikërisht për këtë arsye, kujtesa nuk është urrejtje. Kujtesa është përgjegjësi. Sepse vetëm duke mos harruar, mund të sigurohemi se tragjedi të tilla nuk do të përsëriten më.

***Gazetar profesionist&poet - Tiranë, 14 Korrik 2026**

REAGIMI

Kryesia e OBVLP dënon më ashpërsi deklaratën shokuese të çmendurës së Beogradit zyrtar Paunović

KOSOVA SHTET I LIRË DHE SOVRAN, REALITET I PAKTHYESHËM

Kryesia e OBVLP ka reaguar ashpërsi ndaj deklaratës shokuese të ministres serbe për administratën publike dhe qeverisjen vendore Snezhana Paunović, për spastrimin etnik në Kosovë, duke e konsideruar atë një këmbanë alarmi për gjithë trojet etnike shqiptare.

Armatosja e Serbisë duhet të zgjojë nga gjumi institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë, duke përgatitur një plan kombëtar mbrojtje nga sllavo - komunistët serbë që tokat ilire të jenë të mbrojtura dhe të jetojnë në liri.

Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, në reagimin e saj në rrjetet sociale, ndër të tjera shprehet se "gjuha e përdorur nga kjo ministre e lajthitur e qeverisë serbe, tregon se serbët nuk deshirojnë plan paqeje me shqiptarët, me garancinë e BE dhe SHBA, por duan konflikte në Ballkan e me gjerë".

Lufta e UÇK-së, dhe ndërhyrja ushtarake e NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999 janë lufta më epokale në historinë e civilizimit botëror, ku populli shqiptar i Dardanisë, i okupuar nga sllavët serbë të ardhur nga skarpitet e Rusisë, mbajtën nën terror mbi 100 vite këto troje ilire, u ngrit kundër pushtuesit gjakatar serb.

OBVLP vlerëson se UÇK është simboli i rezistencës për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Bashkë me mbështetjen e NATO-s çliruan njëherë e përgjithmonë tokën ilire të Kosovës.

"Kjo deklaratë e një mistres serbe, në kulmin e absurdit dhe të çmendurisë së saj tregon se Serbia zyrtare nuk do as paqe dhe as integritet në BE. Serbët e sotit të Snezhana Paunović duan vetëm vëllain e tyre, Putinin. Ndaj BE duhet të refuzojë çdo lloj ndihme për Serbinë dhe të dënojë me forcë genocidin e tyre në trojet autoktone shqiptare. Kombi shqiptar duhet të bashkohet rreth flamurit kuq e zi, si në kohën e Kastriotit ndaj sfidave që e presin në shekullin e 21-të" -shprehet kryetarja e OBVLP.

Kryesia e kësaj organizate i bën të ditur të çmendurës së Beogradit Paunović se Kosova shtet i lirë dhe Sovran është realitet i pakthyeshëm.

KOSOVA SHPALL PERSONA NON GRATA MINISTREN SERBE PAUNOVIQ

Ministri i Punëve të Brendshme në Kosovë, Xhelal Sveçla, mori vendim dhe e shpalli persona non grata ministren e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale të Serbisë, Snezhana Paunović, duke ia ndaluar në mënyrë të përhershme hyrjen apo kalimin tranzit përmes Kosovës. Këtë vendim ministri i Brendshëm i Kosovës e mori të martën vonë (14.07.2026) pas një deklarate të ministres serbe Paunović, e cila një ditë më parë deklaroi për mediet në Serbi "se po të ishte në vend të Sllobodan Millosheviqit do ta spastronte etnikisht Kosovën më 1998". Kjo deklaratë e ministres serbe nxiti reagime të ashpra në Kosovë dhe Bruksel. Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, në vendimin e tij thotë se "gjuha e

Paunovićit është vazhdimësi e një politike shtetërore që për shumë dekada ka prodhuar dhunë."

"Kjo gjuhë dhe kjo aspiratë e shpërfaqur nuk është e re. Ajo është vazhdimësi e një politike shtetërore që për shumë dekada ka prodhuar dhunë, krime dhe përpjekje për zhdukjen e shqiptarëve nga trojet e tyre. Urrejtja e tillë e vazhdueshme, e shprehur me tone kërcënuese ndaj rendit kushtetues dhe sovranitetit të Republikës sonë nga ministrja në fjalë, është e papranueshme dhe duhet të dënohet ashpër nga shtetet dhe shoqëritë demokratike që mbrojnë paqen, të drejtat e njeriut dhe nuk tolerojnë retorikë e sjellje që nxit urrejtje, destabilizim dhe përsëritje të politikave kriminale të së kaluarës", thuhet në vendim.

QEVERIA E KOSOVËS KËRKON REAGIM MË TË ASHPËR NGA TIRANA ZYRTARE

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka komentuar deklaratat e ministres serbe mbi spastrimin etnik të Kosovës, si dhe ka kërkuar, sipas tij, një reagim më të madh nga Shqipëria.

"Patjetër, duke qenë se Shqipëria është vendi amë i shqiptarëve dhe duke qenë se në vetë Kushtetutën e Shqipërisë është obligim mbrojtja e shqiptarëve dhe interesave të tyre, unë pres më shumë.



Do të thotë që unë pres një reagim faktik, aktiv ndaj këtyre kërcënimeve. Për shkak se këto nuk janë deklarata, këto janë edhe kërcënime, të cilat bazohen në të kaluarën, siç e thashë, shumë të dhimbshme tonën, edhe në sjelljen e Serbisë.

Unë besoj se reagimi i Shqipërisë duhet të jetë më konkret dhe më aktiv. Kjo ka qenë deputete, ku ka qenë pjesë e Grupit të Miqësisë Serbi-Shqipëri, në të cilin, fatkeqësisht, kanë marrë pjesë shovinistë serbë.

Duhet një demaskim i kësaj sjelljeje dyfytërshe të Beogradit, sepse nuk ka probleme me Kosovën, por probleme me shqiptarët", tha Sveçla për Euroneës Albania.

DEKLARATA E PAUNOVIQ, TRONDITËSE DHE FYERJE PËR VIKTIMAT E LUFTËS

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Ferit Hoxha me anë të një postimi në rrjetet

• **TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: OBVLP vlerëson se UÇK është simboli i rezistencës për mbrojtjen e trojeve etnike shqiptare. Bashkë me mbështetjen e NATO-s çliruan njëherë e përgjithmonë tokën ilire të Kosovës**

sociale, i ka cilësuar si të papranueshme dhe fyese deklaratat e ministres serbe për Administratën Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Serbisë, Snezhana Paunović për një spastrim të madh etnik në Kosovë.

Deklarata e një anëtarit të qeverisë së Serbisë është e papranueshme, tronditëse dhe një fyerje e rëndë për viktimat e luftës. Ato minojnë përpjekjet për pajtim dhe bashkëpunim, ushqejnë mosbesimin dhe urrejtjen, si dhe rihapin plagë që ende nuk janë shëruar. Procesi i normalizimit dhe i pajtimit, për të cilin Kosova, Serbia dhe i gjithë rajoni kanë aq shumë nevojë, kërkon para së gjithash përgjegjësi, refleksion dhe guxim për t'u përballur me të kaluarën", shprehet kryediplomati shqiptar.

Në mediat serbe, ministrja Paunović lëshoi një deklaratë skandaloze duke u shprehur se "Për të metat dhe budallallëkun tonë, nëse do të kisha qenë e lirë si Millosheviçi, do ta kisha pastruar etnikisht Kosovën në vitin 1998".

MINISTRI HOXHA I KËRKON HOMOLOGUT SERB TË HEDHË POSHTË RETORIKËN QË NXIT TENSIONE

17 korrik 2026- Gjatë qëndrimit të tij në Uashington, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha u takua në marginat e Ministerialit për rikthimin e terrorizmit politik me Ministrin e Jashtëm të Serbisë, Marko Gjuric, të cilit i kërkoj të hedhë poshtë retorikën që nxit tensione.

Të dy ministrat shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale dhe perspektivat e ardhshme.

Në një postim në rrjetin social X, Hoxha njoftoi se gjatë takimit ripërsëriti qëndrimin e Shqipërisë në lidhje me deklaratat e papranueshme të një anëtareje të Qeverisë së Serbisë për Kosovën.

"Gjithashtu përsëriti qëndrimin e qartë dhe të vendosur të Shqipërisë në lidhje me deklaratat e papranueshme dhe të papërgjegjshme të bëra së fundmi të një anëtareje të Qeverisë së Serbisë, si dhe theksova nevojën për të hedhur poshtë pa mëdyshje, retorikën që nxit tensionet, minon stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal dhe që bie ndesh me frymën e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe vlerave evropiane.

Kjo është ajo që përfaqëson diplomacia: angazhimi në dialog të hapur, shikimi i njëri-tjetrit në sy, përballja me realitetin dhe adresimi i dallimeve me përgjegjësi", shkruan Hoxha.

Edhe kryeministri Edi Rama ka reaguar pas deklaratës skandaloze të ministres serbe për Administratë Publike dhe Vetëqeverisje Lokale, Snezhana Paunović, për "spastrim etnik" të Kosovës.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, të enjten e 16 korrikut, Rama theksoi se



Shqipëria ka reaguar zyrtarisht përmes ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, duke shtuar se një shtet që respekton veten nuk ka pse të përgjigjet ndaj çdo deklarate provokuese që vjen nga Beogradi.

PROMOVIMI

Ish ushtarakë madhorë vlerësojnë rrugëtimin e autorit si prind, qytetar dhe kontributin e tij në ndërtimin e një ushtrie profesioniste

ISH-DREJTUES TË LARTË TË USHTRISË VLERËSOJNË VEPRËN E GJENERAL SHULKUT

Nexhbedin BASHA*

Më 14 korrik, në Tiranë, në praninë e kolegëve ushtarakë, personaliteteve të jetës publike, miqve, familjarëve, gazetarëve dhe dashamirësve të librit, u promovua monografia "Mes uniformës dhe kohës" e gjeneral Major Ismail Shulku.

Veprimtarinë e hapi vetë autori, i cili shprehu mirënjohjen për të gjithë ata që e mbështetën në rrugëtimin e tij jetësor dhe krijues, veçanërisht fëmijët, bashkëshortet e tyre, nipërit e mbesat, që e nxitën të përmbledhonte në një vëllim kujtimet, ditarët, mbresat dhe dëshmitë e një jete në shërbim të atdheut. Duke shpjeguar titullin "Mes uniformës dhe kohës", ai theksoi se uniforma përfaqëson misionin, disiplinën, përgjegjësinë dhe besnikërinë ndaj vendit, ndërsa koha është dëshmitarja e sfidave, sakrificave, ndryshimeve dhe përvojave njerëzore që i japin kuptim këtij rrugëtimi. Autori evidentoi gjithashtu kontributin e poetit dhe gazetarit Nexhbedin Basha për idenë e titullit dhe konceptimin e kopertinës së librit.

Veprimtaria u moderua me profesionalizëm nga gazetari Dëfrim Met'hasani, i cili vuri në pah vlerat dokumentare, historike dhe njerëzore të monografisë "Mes Uniformës dhe Kohës". Ai shprehu vlerësim për autorin dhe familjen Shulku, duke kujtuar me respekt edhe bashkëshorten e ndjerë, Bajame Shulku, e cila, megjithëse nuk jeton më, mbetet pjesë e pandarë e rrugëtimin jetësor dhe shpirtëror të autorit, siç dëshmohet edhe në faqet prekëse të librit. Po ashtu, ai vlerësoi mbështetjen e fëmijëve, bashkëshorteve të tyre, nipërve e mbesave në realizimin e kësaj veprë dhe falënderoi të gjithë të pranishmit që, me pjesëmarrjen e tyre, i dhanë promovimit një atmosferë të ngrohtë, miqësore dhe dinjitoze.

ISH-DREJTUES TË LARTË TË USHTRISË VLERËSOJBE VEPRËN E GJENERAL SHULKUT

Në promovim përshëndetën disa personalitete, ish-drejtues të lartë të ushtrisë shqiptare.


Kujtim Çako, ish-zëvendësministër i Mbrojtjes dhe aktualisht Drejtor i Përgjithshëm i AKU-së, e cilësoi librin një veprë me rëndësi historike e dokumentare, që ruan kujtesën institucionale të Forcave të Armatosura dhe shërben si burim studimi e frymëzimi për brezat e ardhshëm të ushtarakëve.

Bajram Mane, ish-zëvendësministër i Mbrojtjes, koleg dhe mik i autorit, vlerësoi Ismail Shulkun si një ushtarak karriere me integritet, kulturë të lartë profesionale dhe përkushtim të palëkundur ndaj detyrës, cilësi që e kanë shoqëruar në të gjithë rrugëtimin e tij.

Vlerësimet e veçanta përcolli edhe Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, e cila e cilësoi autorin jo vetëm një drejtues të aftë ushtarak, por edhe një model frymëzues për brezat e rinj të oficerëve, falë profesionalizmit, korrektësisë, vizionit dhe dimensionit të tij njerëzor.

Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, ish-Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kujtoi se Ismail Shulku ka qenë një nga figurat që ka ndikuar në formimin e tij profesional në fillimet e karrierës, duke e konsideruar një shembull të liderit, urtësisë, përkushtimit dhe fisnikërisë në shërbim.

- Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, e vlerësoi autorin jo vetëm një drejtues të aftë ushtarak, por edhe një model frymëzues për brezat e rinj të oficerëve, falë profesionalizmit, korrektësisë, vizionit dhe dimensionit të tij njerëzor



Ganiu Elezi, ish-komisar, theksoi se kjo monografi duhet të zërë vend në bibliotekat e Forcave të Armatosura, pasi përmban përvoja, kujtime dhe vlera të rëndësishme profesionale e njerëzore, ndërsa i uroi autorit shëndet dhe krijimtari të mëtejshme.

Kolonel Zaho Golemi, doktor i shkencave, ndaloi te kontributi i Gjeneral Shulkut në arsimimin dhe kualifikimin jashtë vendit të një brezi të tërë ushtarakësh shqiptarë. Ai kujtoi mbështetjen që kishte marrë personalisht prej tij gjatë kohës kur Ismail Shulku drejtonte Drejtorinë e Personalit në Ministrinë e Mbrojtjes, duke e cilësuar një drejtues që investonte te njerëzit dhe te e ardhmja e ushtrisë.

NJË VLERËSIM NDRYSHE MBI LIBRIN

Në këndvështrimin tim ndryshe mbi librin, (si gazetar profesionist, poet e analist), , po evidentoj faktin e panjohur të kontributit të këtij autori edhe si krijues

letrar. Në fjalën time, ndër të tjera nënvizova:

"Një zbulim i veçantë për mua, gjatë leximit të librit, ishte Ismail Shulku poet. Pas figurës së generalit, të njohur për disiplinën dhe përgjegjësinë, fshihet një shpirt i ndjeshëm dhe një zemër e hapur ndaj artit. Poezitë kushtuar bashkëshortes së ndjerë, Bajames, janë ndër faqet më prekëse të librit. Në vargjet: 'Nuk ka dallgë që na ndan, malli për ty - oqean...' ndiejmë fuqinë e një dashurie që kapërcen kohën, largësinë dhe çdo mungesë. Edhe kur u drejtohet fëmijëve, nipërve, mbesave dhe stërmbesës Livija, vargjet e tij janë copëza jete, kujtese dhe dashurie familjare. Vargu 'S'jam Agoll, as Kadare, ndoshta ushtarak i shquar...' dëshmon thjeshtësinë e një njeriu që nuk kërkon krahasime, por shpreh me sinqeritet ndjenjat e tij. Pikërisht në këtë bashkim mes uniformës dhe poezisë shfaqet përmasa më njerëzore e Ismail Shulkut. Gjenerali Shulku nuk mban mbi supe vetëm gradat

e larta të karrierës ushtarake. Ai mban edhe nderimin e bashkëqytetarëve të tij si 'Qytetar Nderi i Dibrës', së bashku me medalje, dekorata dhe vlerësime të tjera të fituara gjatë shërbimit ndaj atdheut. Këto janë dëshmi të një rruge të ndërtuar me punë, përkushtim, sakrificë dhe integritet."

Në përfundim, promovimi u shndërrua në një vlerësim të merituar për një jetë të tërë në shërbim të Shqipërisë dhe të Forcave të Armatosura.

Libri "Mes Uniformës dhe Kohës" vjen si një monografi me vlera të veçanta historike, profesionale, dokumentare dhe njerëzore, duke ruajtur kujtesën e një brezi ushtarakësh dhe duke lënë një trashëgimi të vyer për studiuesit, ushtarakët dhe lexuesit. Ai dëshmon se përtej gradave dhe detyrave mbeten njeriu, koha dhe vlerat që ai ndërton e u përcjell brezave.

*Gazetar & poet - 10 korrik 2026

90-VJETORI I DITËLINDJES

XHEMAL MEÇI, KORIFEU I DIJES QË E SHNDËRROI HISTORINË NË KUJTESË TË GJALLË TË KOMBIT

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Prof. Xhemal Meçi – “Mjeshtëri
i Madh” dhe “Qytetar Nderi” i
Pukës, autor i veprave mad-
hore “Traditi iliro- arbërore”, “Kanuni i
Lekë Dukagjinit”, (dy vëllime, në varianti
Pukës dhe variantin e Mirditës), “Puka
që në lashtësi”, etj, këtë 23 korrik festoi
me madhështi 90-vjetorin e ditëlindjes.

Nëntëdhjetë vjet jetë është një kuotë shumë e lartë. Prof. Meçi ka meritën se e ka arritur këtë kuotë të lartë, jo i drobitur, por në formë të shkëlqyer fizike dhe mendore, një formë që do ta kishin zili edhe të rinjtë.

Në këtë jubile të 90-vjetorit të ditëlindjes, na gëzon pa masë fakti që profesorit shfaqet kudo si një intelektual i përgjegjshëm, predikues i vlerave tona kombëtare, i dashurisë për Atdheun, si simbol i dijes, përkushtimit qytetar, paqes dhe dashurisë njerëzore. Mishërues dhe përcuesi i vlerave më të spikatura njerëzore, intelektuale, krijuese e profesionale, i interesave të gjera dhe i kontakteve të gjalla me njerëzit, i dëgjueshëm dhe debatues me argumenta kokëforta.

Ai vlerësohet dhe nderohet sot, si një personalitet që ia kushtoi jetën studimit të historisë. Dhe jo vetëm vetë, por duke ftuar edhe disa historianë të Akademisë së Shkencave dhe duke i çuar nëpër vende në Pukë, ku ishin gjurmët e lashtësisë së kësaj treve emërndritur në historinë tonë kombëtare.

Xhemal Meçi, i erdhi Pukës në kohën e duhur, si intelektual i paqtë dhe i arsyeshëm, që mundi të çante pa droje mespërmes terrin, si një shkëndijë drite ngadhënjimtare dhe të flakadantë, si një moment shprese për Kabashin që e lindi 90 vjet më parë dhe Pukën që e rriti këtë intelektual me vlera të mëdha.

Në kujtesën e historisë dhe arsimit, Xhemal Meçi mbetet ndër ato emra të veçuar, të cilët erdhën për të mbetur përgjithmonë si jetësorja e patjetërsueshme e që me punën e tij pasionante arriti t'i shndërronte ata në po-din e famës. Ai është e do të mbetet në memorien e të gjithëve si një testament i çmuar i arsimit dhe historiografisë në vendin tonë.

Sepse, gjithmonë dhe kurdoherë, inteligjenca e tij prej dishepulli dhe shërbyesi, shpërfaqet në botën e inteligjencës dhe dijes në Pukë, Shkodër e në gjithë Shqipërinë si një vullnesë e mirë, si një motivim për studiuesit e rinj.

Ndaj dhe konsiderohet si një nga figurat dhe personazhet më të rëndësishëm të historisë së arsimit shqiptar, ku përgjatë gjithë rrugëtimit të vet tregoi vlera. Sepse fjala e tij e matur dhe me vend ishte dhe është si një prekje shëruese, si një balsam që paqton lëngimin, dhe që qasej e qaset të mbajë në jetë besimin tek populli pukjan e gjithëkombëtar, të cilët i janë mirënjohës ndikimit pozitiv që mëshiroi, mësuasi, studiuesi e historiani Xhemal Meci.

**VEPRA SHUMËDIMENSIONALE
STUDIMORE - SHKENCORE,
PUBLICISTIKE E BOTUESE E
PROF. XHEMAL MECIT**

Në këtë 90-vjetor të ditëlindjes së tij është rasti të evidentojmë faktin që Prof. Meçi është i mirënjohur, jo vetëm në Pukë e në qarkun e Shkodrës, por në gjithë Shqipërinë e hapësirën mbarëshqiptare në botë, si studiues, etnograf, historian dhe mësues shembullor, i cili mban titujt “Mjeshtër i Madh” dhe “Qytetar Nderi i Pukës”, sepse Ai ka dhënë një kontribut të vyer në mbledhjen e traditave, historisë, toponimisë dhe etnografisë së trevës së Pukës dhe Veriut të Shqipërisë.

Dukshëm kjo reflektohet në mbi 100 artikuj të mirëpëgatirur prej tij dhe të botuar në buletine shkencore e në shtypin periodik përgjatë 60 viteve,

- ***Vepra e tij studimore-shkencore e publicistike e rendit me elitën krijuese të kombit, si simbol i dijes, përkushtimit qytetar, pages dhe dashurisë njerëzore***

nga 1965-2025, të karakterit shken-
cor si dhe në veprat e tij madhore:

- “Traditë Iliro- Arbërore”;
- “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Vari-
anti Pukës, Itali 1996;
- “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, vari-
anti i Mirditës, Tiranë, 2002;
- “Puka që në lashtësi” , Tiranë,
2003;
- “Kabashi”, Tiranë, 2008;
- “Poeti i Malësisë”, Tiranë, 2013;
- “Poeti i Kabashit” , Tiranë, 2014,
- Puka (guidë),Tirane 1998, (shqip
-anglisht-frëngjisht); etj. etj.

Këto vepra madhore që qëndrojnë dinjitetshëm në panteonin e vlerave kombëtare bartin histori reale për vende, tope, kështjella, të cilat shoqërohen me legjenda e tregime të moçme. Kësisoj, Prof. Meçi nuk është vetëm një gjurmues i arkivit të gjallë, por edhe studiues dhe sistemues i arkivit të dokumentuar, si edhe në rastin e monografisë kushtuar Haxhi Rrustë Kabashit.

Ndërsa në librin e botuar para dy viteve "Na ka ç'u Shkodra një fjalë" të Prof. Meçit gjejnë pasqyrim veprimtari akademik - shkencor, të zhvilluara në Shkodër, Pukë e Tiranë, me objekt studimin e historisë së rezistencës së shqiptarëve në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës së rrethuar prej ushtrive pushtuese serbo-malazeze (Nëntor 1912 - maj 1913), si një prej luftërave më heroike dhe po aq të lavdishme të kombit shqiptar, si dhe për traditat, kulturën e lashtësinë e gjuhës shqipe.

Nëpërmjet hulumtimit të studimeve skurpuloze, autori i këtij libri sjell për lexuesin shkrimet interesante: "Puka - një qytet i bukur turistik malor" (ballë madhështisë së Alpeve Shqiptare), në 110-vjetorin e hapjes së shkollës Shqipe të Kabashit (1914-2024); "Abacia e Shën Palit të Pukës, Grykë Kabash në 1440 - vjetorin e saj", etj.

Duke qenë një mësues e studiues i përkushtuar e duke shërbyer me devotshmëri e profesionalizëm në detyra dhe pozicione të ndryshme, që nga pozicioni i mësuesit, më tej drejtor shkollë, drejtues i kabinetit pedagogjik të rrethit Pukë, përgjegjës, specialist dhe drejtor i muzeut historik të rrethit Pukë, ku ende vazhdon me pasionin e tij të shërbejë në muzeun e arsimit “Migjeni” dhe njëkohësisht në pavijonin e ekspozitës “Etno-kulturore” Pukë, prof. Meçi u transmeton grupmoshave të ndryshme vendase dhe të huaja, si dhe Trupit Diplomatik të atashuar në Shqipëri, trashëgiminë tonë kulturore që nga periudha Iliro-Arbërore e deri sot.

Ju të dashur miq pukjanë e dini se sa me interes është pritur vepra e prof. Meçit për Kalanë e Dalmaces (Komanit). Kësisoj Ai ka lënë gjurmë të pashlyera dhe ka fituar mirënjohjen e brezave që edukoi me dashurinë për dijen, për atdheun dhe me virtyte qytetare. Librat e tij "Migjeni në Pukë" e "Ndue Jak Pjetri - Mesues i Popullit", (me bashkautor), janë një kujtesë e saktë që përcjell nivelet kohore të zhvillimit arsimor në këtë trevë, vështirësitë e para por edhe pasionin e madh për dije.

Formimi i tij si malësor me tradita dhe shkollimi i lartë, plus pasioni dhe këmbëngulja në hulumtimin shkencor, përbëjnë tri tipare të arrira të këtij njeriu të dalluar në fushën e dijes, të cilat gjenden sot në librat e tij, por edhe në punimet shkencore – artikujt që botoi te gazetatat “Bashkimi” në krye të herës e më vonë te gazetatat “Albania”, “RD”, “Republika”, “Nacional”, “Tirana Observer” e në vijimësi te gazeta jonë “VETERANI”.

Si një nga drejtuesit kryesorë të OBVLP dhe kryeredaktor i gazetës “VETERANI” kam patur kënaqësinë dhe privilegjin ta kem firmën autoriale të prof. Meçit në pothuajse 456 numrat e kësaj gazete të botuar në harkun kohor të tri dekadave të fundit, ku me prurjet e tij interesante në artikuj mjaftë profesional për historinë e personalitetet të saj, ja ka rritur autoritetin dhe prestigjin këtij organi konkurues në tregun mediatik shqiptar..

Deputi Prof. Meçi është një personalitet shumëdimensional me interesa të gjera dhe me njohje të madhe që vjen nga puna studimore me produkt mjaftë cilësor publicistik, historik e shkencor. Madje, ai herë – herë i tejkalon interesat historike, si në rastin e botimit para një viti të librit “Dëshmorët e Atdheut të Pukës” (Vëllimi I), një vepër analitike, por edhe me informacion të detajuar dhe të saktë, që trajton mirëfilltazi historinë dhe profilin patriotik të të rënëve nga krahina e Pukës, e që dokumenton ngjarje dhe dëshmorët që dhanë jetën për lirinë, pavarësinë dhe mbrojtjen e trojeve shqiptare ndër vite.

Kësisoj, dashuria për vendlindjen shprehet tek ky personalitet i shquar në fushën e studimeve dhe botimeve, së pari në njohjen e historisë së saj sidomos kur është fjala për Pukën, këtë trevë të njohur, ndaj dhe do ta thellonte këtë punë dhe do t'i jepte krah kësaj dashurie me këtë libër mjaft të rëndësishëm, ku evidenton disa ngjarje të rëndësishme në historinë e Pukës, që rezonojnë në historinë kombëtare dhe anasjlltas.

Ai e shikon historinë e Pukës si pjesë integrale e historisë kombëtare dhe evidenton pikërisht ato ngjarje të cilat përbëjnë pikën kulmore të ekzistencës së kësaj krahine dhe të kombit në tërësi, ku pasqyron më së miri me dokumenta ato figura dhe ngjarje sa dramatike aq edhe burrërore, duke sjellë kështu në mënyrë bindëse dhe me metoda shkencore që përvijohen nga fakti tek argumenti dhe nga argumenti te dokumenti ose nga e treta drejt së parës.


Ajo që vihet re tek ky personalitet që punoi në heshtje, është riorganizetiti shkencor dhe ftesa për debat për mjaft probleme të historisë, me qëllimin që historia të mos shkruhej mbi bazë oreklesh ose nga politika e ditës. Ishte dhe është në një farë mënyre edhe sot në moshën 90-vjeçare, një historian që të hedh dorashkën për debat shkencor dhe pranon vetëm vërtetësinë e faktit dhe këtë të mbështetur mirë jo mbi sajesa, por mbi dokumenta të besueshme dhe origjinale.

Sepse dashuria për historinë krahinore, por edhe kombëtare duhet mbështetur patjetër edhe në aftësinë e në përvetësimin e dijes, dhe kësaj ia doli me sukses në rrugëtimin e tij akademiko-shkencor prej më se shtatë dekada.

TITUJT DHE MEDALJET

Si një nga figurat e shquara të arsimit dhe historiografisë, i përkushtuar për Shqipërinë, për lirinë, përparimin, demokracinë, me vlera të mëdha njerëzore dhe mbi të gjitha me kontribut titanik studimor-shkencor, Xhemal Meçit është vlerësuar nga organizma dhe forume nga më prestigjiozet, me urdhra, medalje, e dekorata si:

- Medalje “Naim Frashëri” nga Kuvendi i Shqipërisë ,Tiranë, 1972;
- Titull Nderi “Mirënjohje e qytetit Pukë”, Bashkia Pukë, 2000;
- Urdhri: “Naim Frasheri i Argjendtë”,



Presidenti i Republikës,Tiranë, 2000;

- Urdhri: “Mjeshtër i Madh”, Medalje e Artë, Presidenti i Republikës , Tiranë, 2011;

“Çmimi i Virtytit”- Për veprimtari të shquar në shërbim të Paqes, Progresit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut-nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, Tiranë, 2013.

Veptra shkencore studimore e Xhemal Meçit është një diamant i stolisur në memorien tonë, është një pishtar i ndezur që brezat në vijim do ta trashëgojnë dhe që i drejtohen edhe sot qytetarë, lexues e studiues, profesorë dhe Akademik ta çojnë përpara.


Prof. dr. Xhemal Meçi mbushi (me 23 korrik 2026) plot nëntëdhjetë vjeç dhe ashtu i qetë si gjithmonë është nisur tek të njëqintat. Ndaj dhe për zemërisht i urojmë që Zoti t'i dhurojë akoma jetë të gjatë, të shëndetshme dhe të lumtur, këtij korifeu të dijes e të shkencës, këtij burri kaq të urtë e të thjeshtë, këtij edukatori të tërë brezash, këtij kontributori të papërsëritshëm në fushën e studimeve historike, këtij burri të madh të kombit tonë.

PROFILI

Vështrim biografik dhe kritiko-shkencor mbi jetën, veprën dhe kontributin e një studiuesi të historisë ushtarake shqiptare

Prof. Dr. Bernard Zotaj - Një jetë në shërbim të historisë, dijes dhe kujtesës kombëtare

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj është një jetë e lidhur me ushtrinë, arsimin, historinë dhe librin. Një studiues që ka bërë të flasin dokumentet, një autor që ka nxjerrë nga harresa shumë figura dhe ngjarje, dhe një pedagog që dijen e ka parë gjithmonë si përgjegjësi ndaj brezave...



Nga Agim LIKA
Poet, historian dhe studiues

HYRJE

Në historinë e institucioneve ushtarake dhe të mendimit historik shqiptar ka personalitete që nuk mund të vlerësohen vetëm përmes detyrave që kanë kryer, gradave që kanë mbajtur apo titujve akademikë që kanë fituar. Vlera e tyre e vërtetë qëndron në gjurmën që lënë pas: në dijen e përcjellë, në dokumentet e nxjerra nga harresa, në figurat historike të rikthyera në kujtesën kolektive dhe në brezat që kanë formuar.

Një personalitet i tillë është Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, ushtarak karriere, pedagog, historian, studiues, autor dhe bashkautor i një numri të madh veprash, i cili për më shumë se katër dekada e ka lidhur jetën e tij me Forcat e Armatosura, arsimin ushtarak, kërkimin shkencor dhe historinë kombëtare.

Veprimtaria e tij përbën një ndërthurje të veçantë ndërmjet përvojës së ushtarakut dhe analizës së studiuesit, ndërmjet disiplinës së profesionit dhe pasionit për dokumentin, ndërmjet historisë së madhe kombëtare dhe kujtesës së njerëzve të thjeshtë që e kanë bërë atë histori.

Për të shkruar për Bernard Zotajn nuk mjafton një renditje kronologjike e detyrave dhe botimeve. Duhet të kuptohet boshti që bashkon të gjithë veprimtarinë e tij: përkushtimi ndaj kujtesës historike dhe bindja se historia duhet të dokumentohet, studiohet dhe t'u transmetohet brezave.

RRËNJËT FAMILJARE – ATD-HETARIZMI SI TRASHËGIMI

Bernard Hiqmet Zotaj lindi më 8 qershor 1955 në Ramicë të Vlorës, në një familje me tradita të hershme atdhetare. Kjo prejardhje nuk përbën thjesht një të dhënë biografike. Ajo është një nga çelësat për të kuptuar orientimin e mëvonshëm të jetës dhe veprës së tij.

Familja Zotaj ishte e lidhur me ngjarjet historike të krahinës dhe të vendit. Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirim-

tare, shtëpia e familjes u bë bazë e luftës në zonën e Vlorës. Gjyshi i tij nga nëna, Shefit Xhafaj, është dëshmor i Luftës së Vlorës të vitit 1920, ndërsa xhaxhai, Sadik Zotaj, ra dëshmor për Atdheun në vitin 1943.

Prindërit, Hiqmet dhe Sibe Zotaj, punëtorë dhe veteranë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, përcollën te fëmijët frymën e punës, të sakrificës dhe të respektit për historinë. Ata u vlerësuan me titullin “Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it”, ndërsa Sibe Zotaj edhe me diplomën “Mirënjohja e Labërisë”.

Në këtë mjedis familjar, historia nuk ishte një rrëfim i largët. Ajo jetonte në kujtesën e familjes, në emrat e të rënëve, në tregimet e brezave dhe në vetë ndërg-

shkencor.

Pikërisht kjo ndërthurje përbën një nga karakteristikat kryesore të profil-it të tij profesional. Bernard Zotaj nuk iu afrua historisë ushtarake vetëm nga pozicioni i studiuesit të dokumenteve. Ai e njohte nga brenda organizimin ushtarak, jetën e reparteve, procesin e komandimit, stërvitjen, doktrinën dhe funksionimin e institucioneve arsimore ushtarake.

Kjo përvojë praktike i dha studimeve të tij një dimension të veçantë profesional.

NGA KOMANDIMI TE PEDAGOGJIA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Karriera e Bernard Zotajt shtrihet në më shumë se katër dekada.



jegjen e komunitetit.

Pikërisht këtu mund të kërkohej një nga burimet e pasionit të mëvonshëm të Bernard Zotajt për historinë, dëshmorët, veteranët, figurat ushtarake dhe kujtesën e krahinës së Labërisë. Në veprën e tij, historia kombëtare dhe historia familjare shpesh takohen. E përgjithshmeja dhe personalja nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën, por ndërtojnë një marrëdhënie organike.

FORMIMI ARSIMOR DHE AKADEMIK

Rruga e tij arsimore dëshmon një proces të vazhdueshëm formimi.

Në vitet 1970–1974 kreu shkollën e mesme të përgjithshme “Hasan Pulo” në Orikum të Vlorës. Në periudhën 1975–1979 përfundoi Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, duke hyrë në radhët e kuadrove të Forcave të Armatosura.

Në vitet 1980–1983 vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Partisë, ndërsa në periudhën 1987–1989 përfundoi Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. Krah arsimin institucional, ai kreu edhe kurse të ndryshme kualifikimi në fushën e historisë ushtarake, mbrojtjes dhe sigurisë.

Ky formim i gjerë i dha mundësinë të ndërthurte

tri fusha themelore: praktikën ushtarake, pedagogjinë dhe kërkimin

Nga viti 1979 deri në vitin 1982 ai kreu detyra si komandant toge këmbësorie, komisar kompanie dhe në funksione drejtuese të organizatës së rinisë në një brigadë këmbësorie në Durrës.

Në vitet 1982–1987 veprimtaria e tij u lidh me ngushtë me shkollat ushtarake shqiptare, ku shërbeu si pedagog dhe në detyra organizative e drejtuese.

Pas përfundimit të Akademisë së Mbrojtjes, në periudhën 1989–1995 kreu detyra në Vaun e Dejës dhe në repartet e Tiranës, përfshirë funksione komanduese dhe shtabore.

Në vitet 1998–2001 ishte shef inspektimi në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, specialist në Qendrën e Taktikës dhe pedagog.

Nga viti 2001 deri në vitin 2006 shërbeu si shef dege në Qendrën e Doktrinës pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, ndërsa ushtroi edhe detyrën e kryeredaktorit të “Revistës Ushtarake”.

Në periudhën 2006–2011 ishte shef i Sektorit të Historisë Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes dhe pedagog. Më pas, përvoja e tij u zgjerua edhe në arsimin e lartë civil, ku shërbeu si pedagog dhe dekan i Fakultetit të Shkencave Politike në Shkollën e Lartë Private “Vitrina”.

Në vitet 2011–2014 drejtoi Qendrën e Librit dhe Mbështetjes me Informacion në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, ndërsa më pas vijoi veprimtarinë në Qen-

drën e Doktrinës dhe të Kërkimit dhe në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në këtë rrugëtim, Bernard Zotaj kaloi natyrshëm nga komandimi në pedagogji, nga pedagogjia në studim dhe nga studimi në drejtimin e strukturave të dijes dhe informacionit.

Ky evolucion profesional nuk ishte shkëputje nga përvoja e mëparshme, por zgjerim i saj.

HISTORIA USHTARAKE SI FUSHË E IDENTITETIT SHKENCOR

Kontributi më i rëndësishëm akademik i Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotajt lidhet me historinë ushtarake.

Historia ushtarake është një disiplinë që kërkon më shumë sesa njohjen e kronologjisë së luftërave. Ajo kërkon analizën e organizimit të forcave, doktrinave, strategjisë, taktikës, drejtimit, logistikës, terrenit, moralit dhe marrëdhënies ndërmjet ushtrisë dhe shoqërisë.

Në këtë kuptim, përvoja profesionale e Bernard Zotajt ka qenë një kapital i rëndësishëm shkencor.

Veprat dhe studimet e tij dëshmojnë një interes të vazhdueshëm për historinë e formacioneve luftarake, personalitetet ushtarake, Luftën e Vlorës të vitit 1920, Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, zhvillimin e Forcave të Armatosura dhe mendimin strategjik.

Vepra të tilla si “Arti Ushtarak në Luftën e Vlorës të vitit 1920”, “Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastrë 1943–1944”, “Formacionet partizane në LANÇ”, “Historiku i batalionit partizan ‘Misto Mame’”, “Historiku i çetës partizane ‘Zigur Lelo’ të Smokthinës”, “Teori të Luftës dhe Strategjisë” dhe “Agresion ‘49’ tregojnë gjerësinë e interesave të tij studimore.

Një tipar i rëndësishëm i punës së tij është përpjekja për ta parë historinë ushtarake jo vetëm përmes ngjarjes, por edhe përmes strukturës dhe organizimit. Kjo e afron veprimtarinë e tij me kërkesën themelore të historiografisë ushtarake: të shpjegojë jo vetëm çfarë ndodhi, por edhe si u organizua veprimi, cilët faktorë ndikuan dhe çfarë përvojë historike mund të nxirret prej tij.

MONOGRAFIA SI AKT I RUAJTJES SË KUJTESËS

Një shtyllë tjetër e rëndësishme e krijimtarisë së Bernard Zotajt është monografia.

Në veprat e tij shfaqen figura të njohura kombëtare, ushtarakë, dëshmorë, veteranë, personalitete lokale dhe njerëz që kanë lënë gjurmë në komunitetet e tyre.

Tituj si “Oxhaku i Zote në Smokthinë”, “Rrëfimet e Nënë Zybës”, “Biseda me babain vazhdon...”, “Prushi i Labërisë”, “Yjet e Ramicës”, “Xhenieri i martirizuar”, “Gjeneral Thoma Xhixho, i pari komandant i Akademisë Ushtarake Shqiptare”, “Qemal Stafa – Hero i Popullit”, “Rrëfime të komandantit me pesë plagë” dhe shumë të tjerë dëshmojnë një

(Vijon në faqen 9)

PROFILI

Ka evidentuar njerëz dhe ngjarje që mund të mbeteshin jashtë historisë së shkruar

BERNARD ZOTAJ, PEDAGOGU DHE PËRCJELLËSI I DIJES

(Vijon nga faja 8)

prirje të qartë: shpëtimin e kujtesës individuale nga harresa.

Në planin metodologjik, kjo lloj vep-
rimtarie ka rëndësi të veçantë. Historia
kombëtare nuk ndërtohet vetëm nga
ngjarjet e mëdha dhe personalitetet
qendrore. Ajo ndërtohet edhe nga
mikrohistoria, nga historia lokale, nga
kujtesa familjare dhe nga dëshmitë in-
dividuale.

Në këtë pikë, kontributi i Bernard
Zotajt merr një dimension të rëndë-
sishëm dokumentues.

Ai ka kërkuar të evidentojë njerëz
dhe ngjarje që mund të mbeteshin
jashtë historisë së shkruar. Nëpërmjet
monografive, ai ka krijuar një hapësirë
kujtese për figura të ndryshme, duke
mbledhur të dhëna, dëshmi, kujtime
dhe dokumente.

Kjo është një punë që kërkon durim
dhe këmbëngulje. Shpesh, doku-
menti i historisë lokale nuk gjendet i
sistemuar në një arkiv të vetëm. Ai
duhet kërkuar në familje, në kujtesën
e bashkëkohësve, në fotografi, letra,



dokumente personale dhe botime të
shpërndara.

Në këtë kuptim, autori merr edhe
rolin e mbledhësit të kujtesës.

**NDËRMJET HISTORISË SHKEN-
CORE DHE KUJTESËS PËRKUJTI-
MORE**

Nga një këndvështrim kri-
tiko-shkencor, vepra e Bernard Zotajt
mund të shihet në ndërthurjen e dy
prirjeve: historiografisë dokumentare
dhe shkrimit përkujtimor.

Kjo ndërthurje përbën një nga
veçoritë e krijimtarisë së tij.

Në studimet me karakter të mirëfill-
të ushtarak, qasja e tij mbështetet te
kronologjia, dokumenti, organizimi i
formacioneve dhe analiza e ngjarjeve.
Në monografitë kushtuar individëve
dhe komuniteteve, shkrimi merr
shpesh një karakter më emocional,
etik dhe përkujtimor.

Pikërisht këtu qëndron edhe një
nga sfidat metodologjike të kësaj lloj
krijimtarie: ruajtja e ekuilibrit ndërm-
jet respektit për figurën dhe distancës
kritike të studiuesit.

Në historiografi, dokumenti duhet
të mbetet themeli i argumentimit.
Dëshmia gojore, kujtesa familjare dhe
rrëfimi personal janë burime me vlerë,
por kërkojnë krahasim, verifikim dhe
vendosje në kontekst.

Në veprën e Bernard Zotajt, vlere më
e madhe qëndron pikërisht në sasinë e
materialit të mbledhur dhe në përpjek-
jen për ta kthyer kujtesën e shpërndarë
në tekst të shkruar. Për studiuesit e ar-
dhshëm, kjo krijon një bazë të rëndë-
sishme dokumentare dhe orientuese.

PEDAGOGU DHE PËRCJELLËSI I DIJES

Një studiues nuk vlerësohet vetëm
nga ajo që shkruan, por edhe nga ajo që
përcjell te brezat.

Bernard Zotaj ka qenë për shumë vite
pedagog në institucionet e arsimit ush-
tarak. Kjo përvojë e ka vendosur në kon-
takt të drejtpërdrejtë me breza oficerësh
dhe studentësh.

Pedagogia ushtarake ka specifikat
e saj. Ajo kërkon ndërthurjen e teorisë
me praktikën, të njohurive historike me
mendimin strategjik dhe të disiplinës
profesionale me aftësinë për të analizuar
situata komplekse.

Kontributi i tij në hartimin e materia-
leve mësimore, dispensave, teksteve dhe
studimeve është pjesë e rëndësishme e
profilit të tij akademik.

Veçanërisht domethënëse është
pjesëmarrja si bashkautor në tekstet e
Historisë së Shqipërisë për klasat e nën-
ta dhe të dymbëdhjeta. Kjo dëshmon
se veprimtaria e tij nuk është kufizuar
vetëm brenda institucioneve ushtarake,
por është shtrirë edhe në arsimin parau-
niversitar.

Në këtë mënyrë, përvoja e studiuesit
është kthyer në dije të transmetueshme.

LABËRIA SI HAPËSIRË HIS- TORIKE DHE SHPIRTËRORE

Në veprën e Bernard Zotajt, Labëria
zë një vend të veçantë. Ajo nuk është
vetëm vendlindje. Është hapësirë kuj-
tese, identiteti dhe frymëzimi.

Ramicë, Smokthinë, Mesaplik, Trag-
jas, Kuç, Vlorë dhe figura të ndryshme
të kësaj treve shfaqen vazhdimisht në
botimet e tij.

Kjo lidhje me vendlindjen nuk duhet
parë si kufizim krahinor. Përkundrazi,
historia lokale bëhet një dritare për të
kuptuar historinë kombëtare. Lufta e
Vlorës, Lufta Antifashiste Nacionalçlir-
imtare, traditat e qëndresës dhe figu-
rat e Labërisë janë pjesë e historisë së
Shqipërisë.

Në këtë kuptim, Bernard Zotaj ka
kontribuar në ruajtjen e një trashëgimie
që, duke qenë lokale në origjinë, është
kombëtare në domethënie.

KONTRIBUTI INSTITUCIONAL

Veprimtaria e tij nuk është kufizuar
te libri dhe auditori. Ai ka qenë dhe vijon
të jetë i angazhuar në institucione dhe
organizata që lidhen me historinë ush-
tarake, veteranët dhe dëshmorët e Atd-
heut.

Është anëtar i Institutit të Studimeve
të Historisë Ushtarake, anëtar i bordit të
revistës “Studime për Historinë Ushtar-
ake”, kryetar i Shoqatës së Historianëve
Ushtarakë të Republikës së Shqipërisë,
si dhe pjesë e strukturave të organizat-
ave të veteranëve dhe dëshmorëve.

Ky angazhim institucional dëshmon
një konceptim aktiv të rolit të historianit.

Për Bernard Zotajn, historia nuk
është vetëm objekt studimi. Ajo është
edhe përgjegjësi qytetare.



NJOHJA AKADEMIKE DHE VLERËSIMET

Veprimtaria e tij shkencore është
shoqëruar me njohje akademike dhe in-
stitucionale.

Në vitin 2003 fitoi gradën shkencore
“Doktor i Shkencave” në fushën e mbro-
jtjes, ndërsa në vitin 2011 mori titullin
akademik “Profesor i Asociuar”.

Në vitin 2020 u nderua nga Presi-
denti i Republikës me titullin “Mjeshtër i
Madh”, ndërsa në vitin 2022 mori titullin
“Nderi i Qarkut Vlorë”.

Ai është vlerësuar gjithashtu me
medalje dhe urdhra për shërbimin ush-
tarak, karrierën, kontributin profesional
dhe veprimtarinë shoqërore, si dhe me
vlerësime nga organizata atdhetare, kul-
turore dhe vendore.

Këto vlerësime janë shprehje insti-
tucionale e një veprimtarie shumëv-
jeçare, por pesha e një studiuesi, në
fund të fundit, përcaktohet nga vepra që
lë pas.

Dhe në rastin e Bernard Zotajt, kjo
vepër është e gjerë.

NJË VLERËSIM KRITIKO-SHKEN- COR I VEPRËS

Në një vështrim tërësor, kontributi i
Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotajt mund të
përmbledhet në disa drejtime themelore.

Së pari, ai ka kontribuar në studimin
dhe dokumentimin e historisë ushtar-
ake shqiptare, veçanërisht në çështje që
lidhen me Luftën e Vlorës, Luftën Anti-
fashiste Nacionalçlirimtare, formacionet
luftarake dhe personalitetet ushtarake.

Së dyti, ka dhënë një kontribut
të rëndësishëm në historiografinë
monografike, duke dokumentuar jetë
njerëzish, familje, komunitete dhe figura
që përbëjnë pjesë të kujtesës kombëtare.

Së treti, ka kontribuar në arsimin dhe
mendimin ushtarak, përmes pedagog-
jisë, teksteve, materialeve mësimore dhe
punës në strukturat e doktrinë.

Së katërti, ka ndihmuar në institucio-
nalizimin dhe promovimin e studimeve të
historisë ushtarake, përmes angazhimit
në organizata dhe struktura shkencore.

Së pesti, vepra e tij përfaqëson një
përpjekje të vazhdueshme për të krijuar
një urë ndërmjet historisë akademike
dhe kujtesës shoqërore.

Natyrish, një korpus kaq i gjerë ve-
prash kërkon në të ardhmen edhe një
bibliografi të plotë shkencore, klasifi-
kim tematik dhe analizë të posaçme të
secilës fushë të kontributit të tij. Një stu-

dim bibliometrik dhe historiografik mbi
veprën e Bernard Zotajt do të ndihmonte
për të përcaktuar më saktë vendin e tij
në zhvillimin e historiografisë ushtarake
shqiptare.

Një ndërmarrje e tillë do të ishte me
vlerë jo vetëm për autorin, por edhe
për vetë historinë e mendimit ushtarak
shqiptar.

PËRFUNDIM

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj për-
faqëson një profil të formuar në ndër-
thurjen e disa identiteteve: ushtarakut,
pedagogut, historianit, studiuesit, au-
torit dhe veprimtarit të kujtesës kom-
bëtare.

Ai ka njohur jetën e repartit dhe au-
ditorin, strukturat e komandimit dhe
tryezën e studiuesit,
dokumentin arkivor dhe dëshminë
njerëzore. Kjo shumësi përvojash ka ndi-
kuar në formimin e një vepre të gjerë dhe
të larmishme.

Në një kohë kur harresa shpesh ecën
më shpejt se kujtesa, puna e studiuesve
që mbledhin, dokumentojnë dhe botojnë
merr një rëndësi të veçantë.

Bernard Zotaj i ka kushtuar një pjesë
të madhe të jetës pikërisht kësaj pune.

Ai ka shkruar për luftërat dhe
luftëtarët, për komandantët dhe dësh-
morët, për vendlindjen dhe Labërinë,
për ushtrinë dhe institucionet e saj, për
njerëzit e njohur dhe për ata që rreziko-
nin të mbeteshin jashtë historisë së
shkruar.

Prandaj, bibliografia e tij nuk duhet
parë vetëm si një numër titujsh. Ajo
duhet parë si një hartë e gjerë e kujtesës,
ku secili libër ruan një emër, një ngjarje,
një institucion, një familje apo një pjesë
të historisë sonë.

Vepra e Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotajt
dëshmon se historia nuk ruhet vetvetiu.
Ajo ruhet sepse ka njerëz që kërkojnë do-
kumentin, dëgjojnë dëshminë, verifiko-
jnë faktin dhe marrin përgjegjësinë për
ta kthyer kujtesën në fjalë të shkruar.

Në këtë mision të gjatë, Bernard
Zotaj ka krijuar profilin e një studiuesi
të përkushtuar, që dijen nuk e ka kon-
sideruar privilegj personal, por detyrim
ndaj shoqërisë dhe brezave që vijnë.

Dhe pikërisht këtu qëndron një nga
vlerat më të rëndësishme të jetës dhe ve-
prës së tij: në shërbimin e pandërprerë
ndaj historisë, dijes dhe kujtesës kom-
bëtare.

(Marrë nga Gazeta Destinacioni,
15.07.2026)

82 VJETORI I RËNIES

MUSTAFA GJINISHI – KOMISARI I PARË I ÇETËS PARTIZANE TË PEZËS

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

PATRIOTI QË LIDHI IDEALIN ME NJERËZIT MË TË SHQUAR TË KOHËS

Mustafa Adem Gjinishi lindi më 15 janar 1912 në Peqin, në familjen e Adem dhe Rukie Kaziut. Që në fëmijëri u dallua për zgjuarsin, kulturën dhe etjen për dije. Vëllai i tij i madh, Rexhepi, u kujdes për arsimimin e tij dhe, pas përfundimit të shkollës unike në Peqin, Mustafa vazhdoi studimet në Shkollën Teknike Amerikane “Harry Fultz” në Tiranë, ku studioi gjatë viteve 1924-1930.

Në këtë institucion, ndër më prestigjiozët e kohës, ai u dallua si një nga nxënësit më të mirë, jo vetëm për rezultatet në mësim, por edhe për pjekurinë, kulturën, aftësitë oratorike dhe autoritetin që gëzonte mes bashkëmoshatarëve. Leximi i autorëve të mëdhenj të Iluminizmit francez, si Volteri dhe Rusoja, ndikoi në formimin e botëkuptimit të tij. Ai u afrua me idetë progresiste dhe, nën ndikimin e zhvillimeve politike të kohës, përqafoi ideat komuniste, pa humbur njëkohësisht bindjet e tij demokratike.

Shkolla Teknike u bë vendi ku u formua intelektualisht dhe politikisht. Gjatë viteve të studimit u zgjodh sekretar i klubit të letërsisë dhe, më 1932, sekretar i përgjithshëm i shoqatës së të diplomuarve të shkollës. Pas diplomimit dëshironte të vazhonte studimet për diplomaci jashtë vendit, por regjimi i Mbretit Zog nuk ia mundësoi këtë, duke e konsideruar person me bindje politike të dyshimta.

Në Tiranë dhe më pas në Kavajë hapi librari, ku shpërndante literaturë përparimtare. Në të njëjtën kohë u angazhua në përhapjen e ideve të majta dhe u bë një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Ali Kelmendit.

Gjatë viteve 1930-1935 Mustafa Gjinishi u lidh ngushtë me shumë personalitete të njohura të kohës, si Ali Kelmendi, Riza Cerova, Skënder Luarasi, Asim Vokshi, Demir Godelli, Tajar Zavalani, Petro Marko e të tjerë. Në këtë rreth intelektualësh ai zhvilloi aktivitetin e tij politik dhe organizativ. Ishte pjesë e grupeve të para komuniste që vepronin në Tiranë dhe mbajti lidhje të vazhdueshme me Shkollën Teknike Amerikane, ku vazhonte të ndikonte te rinia me idetë e tij përparimtare.

Në fund të vitit 1933 u arrestua për veprimtari politike dhe u dënua si pjesëtar i grupit që synonte krijimin e një partie komuniste. Edhe gjatë burgimit nuk e ndërpreu aktivitetin politik. Përmes letrave mbante kontakte me bashkëpunëtorët e tij dhe vazhonte të jepte orientime. Një letër drejtuar Riza Cerovës, e fshehur në këmbishën e një të burgosuri tjetër, u zbulua nga administrata e burgut, çka solli tortura të rënda ndaj tij.

Pas dështimit të Kryengritjes së Fierit, megjithëse ndodhej tashmë në burg, u përfshi në procesin politik dhe u dënua fillimisht me vdekje. Falë ndërhyrjes së patriotëve të Peqinit pranë Mbretit Zog, dënimi iu kthye në 101 vjet burg. Edhe nga burgu, nëpërmjet Demir Godellit, ai u bënte thirrje të rinjve shqiptarë të shkonin si vullnetarë në Luftën Civile të Spanjës për të luftuar kundër fashizmit.

ORGANIZATOR I REZISTENCËS ANTIFASHISTE

Pak para pushtimit italian të 7 prillit 1939, Mustafa Gjinishi përfitoi nga amnistia. Ai u angazhua menjëherë kundër pushtimit fashist dhe, për t'i shpëtuar ndjekjes, u largua në Jugosllavi. Në Beograd mori pjesë në organizimin e strukturave antifashiste shqiptare dhe drejtoi të ashtuquajturin “Shtabi i Solidaritetit me Jugosllavinë”.

Në prill të vitit 1941 u kthye fshehurazi në Shqipëri. Fillimisht lidhi kontakte me Grupin Komunist të Korçës dhe më pas shkoi në Pezë, ku bashkëpunoi ngushtë me Myslim Pezën në organizimin e rezistencës së armatosur.



Me krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, më 8 nëntor 1941, u bë një nga anëtarët e saj themelues. Mori pjesë në organizimin e demonstratës antifashiste të 28 Nëntorit 1941 në Tiranë dhe u emërua komisar i parë i Çetës Partizane të Pezës.

Në këtë detyrë kontribuoi në zgjerimin e çetës, duke afruar në Pezë figura të njohura si Vasil Shanto, Qemal Stafa, Mihal Duri e shumë të tjerë. Gjithashtu organizoi aksionin për lirin e Miladin Popoviçit nga burgu i Peqinit dhe punoi për ngritjen e organizimit antifashist në Tiranë, Durrës, Shijak, Kavajë, Peqin, Elbasan, Lushnjë dhe zona të tjera.

Veprimtaria e tij e bëri një nga njerëzit më të kërkuar nga autoritetet italiane. Për të shmangur ndjekjen përdorte pseudonime të ndryshme, si “Alfi”, “Xhindi”, “Dajë” dhe “Tafari”.

ARKITEKT I BASHKIMIT ANTIFASHIST

Një nga kontributet më të rëndësishme të Mustafa Gjinishit ishte roli në organizimin dhe zhvillimin e Konferencës së Pezës më 16 shtator 1942. Ai ishte ndër mbështetësit më të vendosur të idesë se lufta kundër pushtuesit duhej të bashkonte të gjithë shqiptarët, pa dallim feje, krahine apo bindje politike.

Në Konferencën e Pezës morën pjesë komunistë, nacionalistë, zogistë dhe personalitete të pavarura. Nga 18 delegatët u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar me tetë anëtarë, ku Mustafa Gjinishi ishte një nga tre përfaqësuesit e komunistëve. Ai u zgjodh sekretar i Këshillit, ndërsa kryetar u zgjodh Kamber Qafmolla. Për shkak të gjendjes shëndetësore të këtij të fundit, Gjinishi mbajti një pjesë të madhe të barrës organizative dhe politike të këtij institucioni.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare ai u bë një nga anëtarët e tij. Një rol të rëndësishëm luajti edhe në Konferencën e Mukjes, ku u përpoq të ruante frymën e bashkëpunimit ndërmjet Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar. Ai mbështeti që çështja e Kosovës të trajtohej si pjesë e aspiratave kombëtare shqiptare pas përfundimit të luftës.

LUFTËTAR, ORGANIZATOR DHE NDËRMJETËS POLITIK

Gjatë gjithë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Mustafa Gjinishi punoi për krijimin e njësisë guerile, zgjerimin e formacioneve partizane dhe ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare në zonat e çliruara.

Ai u përpoq vazhdimisht të shmangte përplasjet ndërmjet forcave politike shqiptare dhe të siguron-

te bashkëpunimin e tyre kundër pushtuesit. Rapor-tet e tij si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dallohen për objektivitet, analizë kritike dhe përshkrim realist të vështirësive me të cilat përballëj lëvizja gjatë operacioneve gjermane të dimrit 1943-1944.

Në maj 1943 u ngarkua nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të ishte shoqërues, përkthyes dhe koordinator i misioneve ushtarake britanike pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo detyrë dëshmonte besimin që gëzonte si njohës i gjuhëve të huaja, diplomat i aftë dhe drejtues politik.

RËNIA DHE VLERËSIMI I FIGURËS SË TIJ

Në verën e vitit 1944 Mustafa Gjinishi u dërgua në veri, pranë Divizionit I Sulmues dhe më pas Korpusit I Sulmues.

Më 23 gusht 1944 ai u vra në rrethana ende të debatuar nga historiografia shqiptare, në afërsi të fshatit Grevë të Peshkopisë. Versioni zyrtar i kohës e paraqiti si të rënë në luftë kundër forcave gjermane, ndërsa studimet e mëvonshme kanë ngritur interpretime të ndryshme mbi rrethanat e vrasjes së tij.

Në Urdhrin e Ditës të Ushtrisë Nacionalçlirimtare thuhej:

“Ra në fushën e nderit shoku ynë Mustafa Gjini-shi, anëtar i Kryesisë së Këshillit Nacionalçlirimtar dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Luftëtar i palodhur dhe i patrembur, ai dha jetën në vijat e para të luftës për çlirimin e atdheut dhe të popullit shqiptar.”

Në shenjë nderimi, për tri ditë flamuri kombëtar u mbajt në gjysmështizë në repartet partizane.

Pas çlirimit, emri i tij iu dha një shkolle dhe një rrugë në Peqin, si edhe një rrugë në Tiranë. Megjithatë, gjatë viteve të mëvonshme të regjimit komunist figura e tij u la në hije, pasi u akuzua si i lidhur me misionet britanike. Vetëm pas vendosjes së pluralizmit politik, studimet historike nisën të rivlerësonin rolin dhe kontributin e tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Me vendimin nr. 9, datë 20 maj 2003, Komisioni Qendror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut i akordoi Mustafa Adem Gjinishit statusin “Dëshmor i Atdheut”.

Sot, në qendër të qytetit të Peqinit ngrihet busti i tij, ndërsa jeta dhe veprimtaria e Mustafa Gjinishit vazhdojnë të jenë objekt studimi. Një ndër veprat më të rëndësishme kushtuar figurës së tij është monografia “Legjenda Gjinishi përballë së vërtetës”, botuar në vitin 2005 nga studiuesi peqinas Astrit Kazli, e cila sjell dokumente dhe dëshmi mbi jetën, veprimtarinë dhe fatin e një prej figurave më komplekse të rezistencës antifashiste shqiptare.

82 VJETORI

RRUGA E LAVDISHME HEROIKE E BRIGADËS SË XVIII-TË

Para 82 vitesh, më 18.8.1944, në Sllatinë të Dibrës u formua Brigada e XVIII S nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikës e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione.

Komandat i Brigadës XVIII S. qe Esat Ndreu dhe zëvendëskomandant Zoi Themeli, komisar Miço Kallamata dhe zëvendëskomisar Sotir Vullkani. Më pas, komandant brigade kanë qenë edhe Zoi Themeli e Petrit Dume, ndërsa zëvendëskomandant kanë qenë edhe Petrit Dume e Xhevdet Petrela. Komisar qe edhe Ilmi Çausholli dhe zëvendëskomisar qenë edhe Temo Sejko e Milo Qirko; përgjegjës rinie Dhori Shkodrani, sektori i Agjitpropit: Qazim Prishtina (përgjegjës) Muntaz Kodra, Servet Tershana; intendent: Mahmut Ndreu, Bardhyl Papajani, Kin Dushi, oP cer i mbrojtjes Mustafa Novi, oficer informativ Sakip Luku, oficer në sektorin informativ Zennulla Uka (përgjegjës i seksionit).

Brigada që në fillim, sipas detyrave që kishte marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ, nën drejtimin e komandës veprroi së bashku me Brigadat e I, IV, e të V Sulmuese për asgjësimin e sulmeve që ndërmerrnin forcat gjermane e bashkëpunëtorët e tyre, si ajo e mësymjes së tyre nga Hilma, por u shpartalluan dhe



më 23 Gusht 1944 u çlirua Peshkopia dhe gjithë Dibra dhe kjo ditë u shpall dita e çlirimit të Dibrës.

Pas 30 Gushtit Brigada veprroi në luftimet kundra gjermanëve e bashkëpunëtorëve të tyre në Lumë, Kukës e Prizren... Kukësi u çlirua më 18 Nëntor

1944 dhe së bashku me forcat e Brigadës V-të Sulmuese u çlirua Prizreni më 17 Nëntor 1944. Pas kësaj Brigadës iu caktua detyra për asgjësimin e mbeturinave të mercenarëve dhe bashkëpunëtorëve me okupatorët nazifashistë në zonën Mirditë-Pukë.

Për të gjitha këto luftime e aksione të Brigadës është botuar Historiku i Brigadës së 18-të Sulmuese (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare), 18 Gusht -25 Prill 1945, në vitin 2008. Sipas kujtimeme të Hajri Hoxhës, -ish partizan dhe kuadër i kësaj brigade (ish-komisar i kompanisë së shtabit të Brigadës): “Po-thuajse çdo natë Batalionet e Brigadës zinin pusi në istikamet e improvizuara rreth rrugës Prizren – Kukës, poshtë fshatit Bardhoc e të tjerë deri në afërsi të Kukësit që prisnim autokolonën gjermane të tërhiqeshin nga Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër. Po ashtu kishte javë që në ditë të caktuara për afro dy muaj batalionet me radhë ndërmerrnin aksione kundra forcave gjermane në qytetin e Kukësit. Këto jepnin rezultate në dëmtimet që u bënë si në njerëz e materiale autokolonave gjermane apo atyre të vendosura në qytet. Dhe të gjithë partizanët në këtë rast ruajnë pritjen që si para apo pas aksionit të fshatrave të Kukësit që nga Bicaj e Morina ndanin bukën e tyre me ne e çfarë kishin në shtëpi si groshën, dhallë e sidomos turshitë dimërore, sepse po të mos ishte kjo nga do t'i merrnim ne bukën etj. mos kishim magazinat me miell apo të tjerat? Jo, “magazinë” ishte zemra bujare e fshatarësisë si kudo në gjithë popullin shqiptar e sidomos të fshatarësisë edhe në të Dibrës-KrumësKukësit-Pukës e Prizrenit”.

Me çlirimin e Kukësit dhe Prizrenit u bënë ndryshime në udhëheqjen e Shtabit të Brigadës. Esat Ndreu u caktua me forcat e ndjekjes në Shkodër dhe Komandant erdhi Petrit Dume, ndërsa Komisar Hilmi Çausholli, sepse Miçua u caktua Komisar në një brigadë shqiptare në Maqedoni. Në këto ditë çlirimi të Kukësit Hajri Hoxha kujtonte ardhjen në Brigadën e XVII të 112 shokëve e shoqeve që kishin shpëtuar nga kampi nazist gjerman i Prishtinës, ku disa prej tyre u rreshtuan në këtë Brigadë, si i paharruari Kin Dushi që arriti të emërohet edhe Komandant Batalioni. Ai ka shkruar dhe botuar në libër vuajtjet dhe pushkatimet e 105 të rinjve shqiptarë në këtë kamp më 23 Tetor 1944. Po ashtu Kini ka vlerësuar trimërinë e gjithë shokëve që ishin pushkatuar e në mes tyre përmend heroizmin e ish-partizanëve të Batalionit të Dibrës Spiro Velko, Musa Agolli e të rinjve të tjerë dibranë si: Bilal Konxholli, Tasim Shehu, Hamza Shehu.

Pas çlirimit të Atdheut më 29 Nëntor 1944 Brigada e XVIII S, sipas Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ, veprroi deri në Mars 1945 për asgjësimin e disa bandave mercenare të mbetura në zonat e Krumës, Mirditës dhe Pukës. Partizanët e saj kanë qëndruar për disa kohë në Fushë-Arrëz. Pas kësaj në udhëtimet Lumë, Dibër, Gollobordë, Librazhd, Gramsh, Përmet, po sipas Urdhrit të Shtabit të Ushtrisë NÇ mbërritën në Gjirokastrë ku më 23 Prill 1945, efektiv i saj u bashkua dhe u rreshtua në një Brigadë me brigadën e 20-të Sulmuese. Gjatë periudhës 2-mujore efektiv i brigadës i shkakttoi dëme të konsiderueshme armikut.

BRIGADA E 19-TË S: NË NJË LLOGORE KUNDËR ARMIQVE - SHQIPTARË E MINORITARË

Brigada 19-të Sulmuese Partizane u krijua në Theollogo të Sarandës më 30 gusht të vitit 1944, nga përbërja e partizanëve shqiptarë e minoritarë. Për vetë qëllimin e përbashkët, kjo është quajtur “Brigada e vëllazërimit”, midis popullit shqiptar dhe minoritetit grek.

Në Brigadën XIX u rreshtuan partizanë të batalioneve “Pandeli Boçari”, Thoma Lulo”, “Meteoti” (partizanë italianë) e “Thanas Ziko”, me një efektiv rreth 810 vetë të organizuar në 3 batalione. Komanda e Brigadës diten e formimit të saj përbëhej nga këta kuadro: Komandant Andrea Nasi; komisar në P llim Vango Mitrojorgji e me pas Thoma Xhixho, zv/komandant Mehmet Dusha; zv/komisar Lefter Kasneci etj.

Populli i minoritetit grek, duke pasur besim në platformën e Frontit NÇL të udhëhequr nga PKSH mori pjesë masive e aktive në LANÇ, luftoi për një jetë demokratike se do çlirohej nga robëria fashiste, nga regjimi antipopullor i Zogut, se do të siguronin lirinë e demokracinë dhe do t'i zgjidhnin drejt problemet e tij sociale. Dhe ky besim u justifikua mbas çlirimit.

Brigada që nga dita e parë e formimit e deri në fund, ka zhvilluar luftime të ashpra kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ballistë e zervistë, duke u shkakuar atyre humbje të mëdha. Të tilla qenë luftimet në Konispol, Delvinë, Qafë Bot, Muzinë, Pec, Zminec, Stugar, Dhrjovjan, Libo-

hovë, Qafë e Kiçokut e shumë luftime të tjera. Të paharruar do të mbetet lufta frontale e 55 ditëve për mbrojtjen e Konispolit nga forcat gjermane.


Luftime të ashpra kreu Brigada 19 mbi garnizonin e Delvinës ku ishin përqendruar rreth 500 gjermanë dhe 300 ballistë. Në momentet e para u zunë rob 50 ballistë. Por në këtë luftë ranë heroikisht 21 partizanë e kuadro dhe u plagosën 22 të tjerë. Në këto luftime gjermanët bënë barbarizma dhe vandalizma nga më të ashprat mbi trupat e vrarë. Brigada 19-të S mori pjesë në çlirimin e qyteteve Delvinë, Sarandë, Gjirokastrë. Ajo u angazhua në veprimet luftarake për goditjen e asgjësimin e garnizoneve të veçuara te pushtuesit gjerman në zonën përreth kreu goditje të njëpasnjëshme ndaj autokolonave gjermane në rrugët lëvizëse drejt veriut, si dhe shpartalloi bandat e xhandarmërisë dhe të balistolegalistëve në këtë zonë të bregdetit jugor të vendit. Më 1 tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë ANÇSH Brigada e 19-të kaloi në përbërje të Divizionit III së bashku me brigadat 12 dhe 14. Që nga 10 tetori i vitit 1944, iu ngarkua detyra e sigurimit të kuç rit bregdetar Vlorë-Konispol dhe konsolidimit të pushtetit popullor. Miqësia që u gatua dhe u kalit në llogoret e luftës për liri u çimentua me gjakun e Polo Bezhani, Llambro Nikës, Veliko Rexhës e Lejla Malos, Selfo Abedinit, Llambro

Llambraqit, Petro Anagnostit, Urani Bari, Jani Papa, Theodhori Mastora, Lefter Talo, Qirjako Dhroso e shume të tjerë që dhanë jetën në përpjekje me armiqtë. Në luftimet kundër nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre ranë heroikisht 73 partizanë e partizane dhe u plagosën 70 të tjerë ku mbetën invalidë një pjesë prej tyre.

Si për çdo njësi e brigadë partizane që u krijua gjatë LANÇ, edhe për Brigadën e 19-të Sulmuese, dita e formimit të saj mbetet një ngjarje e shënuar për popullin e zonës e rrethit ku ajo lindi, shqiptarë e minoritarë grekë, për Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe për historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në tërësi. Është krijuar tashmë tradita e kthimit të kësaj date në një festë popullore, ku edhe një herë, shpaloset historia e lavdishme e LANÇ, ku kujtohen aksionet e luftërat e kësaj brigade kundër armiqve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, kujtohen e nderohen me respekt ata që ranë në betejat për çlirimin e Shqipërisë, që mbetën yje të pashuar në panteonin e lavdisë, kujtohen gjithë luftëtarët e saj, sakrificat e panumërtat të popullit. Dhe nga përkujtimi i kësaj date historike, përcillet mesazhi i madh: mos e prekni epopenë e madhe të LANÇ, të ruhet e të forcohet vëllazërimi mes popullit shqiptar e minoritetit grek, që u çelikos në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e Shqipërisë.

PERSONAZH

DERVISH HIMA DHE ZENEPE HIMA (QOKU), KONTRIBUT MADHOR PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE DHE GJUHËN SHQIPE



Nga Sakip Cami

Dervish Hima, lindi më 1872 në Strugë, asokohe pjesë e kazasë së Ohrit në vilajetin e Manastirit, me emrin Ibrahim Mehmet Naxhi Spahiu. Babai i tij Maksut Naxhi Spahiu ishte pronar tokash. Ibrahim thirrej shkurt nga familja dhe të afërmit Himë dhe më vonë u njoh edhe zyrtarisht me emrin Dervish Hima, kudo në të gjitha vepërimitarët ku ka marrë pjesë dhe në të gjitha gazetatat ku ka shkruar.

Pasi kreu arsimin fillor në vendlindje, shkollimin unik në Manastir, shkollimin e mesëm në Selanik, Hima shkoi në Stamboll për të vazhduar studimet e larta në Shkollën Mjekësore Ushtarake, të cilën për shkak të ndjekjeve të autoriteteve osmane, e ndërpreu pas dy vitesh.

Gjatë revolucionit xhonturk, Dervish Hima, sikurse disa atdhetarë të tjerë shqiptarë, iu bashkua Komitetit "Bashkim e Përparim", njëri ndër themeluesit e të cilit ishte bashkëkombësi i tij Ibrahim Temo, për të punuar për të ardhmen e Shqipërisë. Për shkak të qëndrimeve të tij, burgoset dhe kalon një kohë të shkurtër në burgun e Yedikule-s. Pas daljes nga burgu, ndërpret studimet dhe u largua nga Stambolli.

Pavarësisht moshës së tij të re, shkoi në Shqipëri dhe u përpoq ta njëhte me nga afër realitetin shqiptar. Ai udhëtoi anë e kënd nëpër nëpër Shqipëri, deri në Kosovë, i veshur si hoxhë, qiraxhi, dervish dhe tregtar. Ndërsa takohej me zotërinjtë dhe tregtarët e shquar të rajonit, ai vizitoi edhe fshatarët dhe vëzhgoi jetën e tyre. Si rezultat i vepërimitarisë së tij, veçanërisht në Durrës, ai mblodhi një sasi të konsiderueshme fondesh për lëvizjen atdhetare dhe krijoi një organizatë të vogël atje si dhe hapi shkollë e botoi disa broshura e gazeta.

U martua me Zenepe Qokun nga Dibra. Zenepe Qoku (Hima) ishte gruaja e parë që mësoi dhe përhap gjuhën shqipe në Dibër. U lind në Dibër të Madhe në vitin 1881. Është e bija e Iljas Pashë Dibrës dhe motra e Shyqyri Bej Dibrës (Qokut). Mësimet e gjuhës shqipe i mori nga Said Najdeni (Hoxhë Voka) i cili hapi të parën shkollën shqipe në Dibër të Madhe në vitin 1900, në shtëpinë e Abdulla Manjanit. Mbas mbylljes së shkollës nga autoritetet turke nxënësit i vijuan mësimet në bodrumet e errëta të dyqaneve e shtëpive në ilegalitet. Si bashkëshorte e gazetarit dhe atdhetarit Dervish Hima, të dy së bashku luftu-

an për gjuhën shqipe dhe pavarësinë e vendit.

Për shkak të kërcënimeve të Sulltan Abdulhamidit II, Hima iku në Bukuresht në vitin 1897, ku u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë, për të vazhduar studimet mjekësore, mirëpo asnjëherë nuk pati mundësi ta përfundonte shkollimin.

Në vitin 1898 botoi një gazetë në gjuhët shqipe, frënge dhe rumune me emrin "Pavarësia e Shqipërisë" dhe filloi të punonte për organizimin e një kongresi mbarëshqiptar. Gazeta kërkonte një Shqipëri të pavarur, të sunduar nga një princ i huaj dhe të mbrojtur nga Fuqitë e Mëdha. Nëpërmjet gazetës që drejtonte Dervish Hima bënte thirrje për bashkimin e vilajeteve shqiptare dhe autonominë e Shqipërisë në kuadër të Perandorisë Osmane. Në vepërimitarinë e tij të gjërë në dobi të çështjes kombëtare, një vend të rëndësishëm zë vepërimitaria e tij botuese dhe publicistike, në të cilat Hima ka lënë një kontribut të madh.

Në vitin 1899 ai nisi punën për or-



Dervish Hima

ganizimin e një kongresi, ku do të merrnin pjesë shqiptarët e Bukureshtit. Në broshurën që përgatitën si ftesë, ai dhe bashkëpunëtorët e tij parashtuan 8 kërkesat e mëposhtme: Dhënie e autonomisë së Shqipërisë; hapjen e shkollave kombëtare shqipe; krijimin e një ushtrie shqiptare, të përbërë nga myslimanë, katolikë dhe ortodoksë; Shqipëria të qeveriset nga një guvernator i miratuar nga sulltani, i zgjedhur nga Fuqitë e Mëdha; faljen e atyre që u larguan nga vendi; krijimin e një asambleje të përgjithshme; krijimi i një buxheti specifik për Shqipërinë; pranimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, krahas osmanishtes.

Për shkak të angazhimit të madh politik në favor të çështjes kombëtare shqiptare, në vitin 1899, Himës iu anulua leja e qëndrimit në Rumani dhe ai u detyrua të kalonte në Itali, ku e vazhdoi vepërimitarinë e tij politike, duke botuar në shqip dhe frëngjisht gazetën "Zani i Shqipërisë" (L'echo d'Albanie) me Mehmet Bej Frashërin. Pas kthimit të

Mehmetit në Stamboll, e drejtoi vetëm gazetën dhe i ndryshoi emrin në "Albania", por me ndërhyrjen e Qeverisë osmane, botimi i asaj gazete u ndërpre. Ambasada osmane në Romë, si ajo në Bukuresht, i kërkoi qeverisë italiane që ta largonte nga vendi. Më 3 qershor 1901 Hima kaloi në Zvicër, ku u muar me vepërimitari atdhetare dhe botoi një gazetë në gjuhën shqipe.

Merr pjesë në rolin e gazetarit dhe botuesit në Kongresin arbëresh të Napolit që u mbajt më 29 prill të vitit 1901 me nismën e arbëreshëve të Italisë. Kongresi nuk doli jashtë kuadrit gjuhësor, madje diskutoi kryesisht çështjen e alfabetit unik të shqipes, duke shtruar nevojën e një alfabeti latin që të shprehte besnikërisht tërë tingujt e gjuhës shqipe. Për shkak të kësaj pjesëmarrje, ambasadori osman i kërkoi Qeverisë italiane përzënie e tij nga vendi, kështu Hima detyrohet të rikthehet në Zvicër; vendoset në Gjenevë dhe vazhdon botimin e gazetës së tij.

"Le Temps" ka botuar, të enjten e 2



Zenepe Hima

majit 1901, në faqen nr 2, një shkrim mbi Kongresin shqiptar të Napolit dhe vendimet e marra prej tij.

Aurenc Bebja, nëpërmjet faqes së tij "Dars (Klos), Mat – Albania", ka sjellë, në shqip, rrëfimin e plotë të gazetës franceze :

Na shkruajnë nga Roma :

Kongresi shqiptar, i sapo mbajtur në Napoli, ka miratuar rezolutat në vijim :

- **Përdorimin e alfabetit latin në gjuhën shqipe ;**
- **Mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha komunat e Italisë – popullata e të cilave është me origjinë shqiptare – dhe përhapjen e gjuhës italiane në Shqipëri.**

Asambleja ka votuar sërish kundër masave të qeverisë osmane që kërcënojnë në Shqipëri ekzistencën e gjuhës dhe kombësisë.

Në fillim të shkurtit 1902, u mblodh në Paris, Kongresi 1-rë i Xhonturqe ose thënë ndryshe Kongresi i Opozitës Liberale Osmane. Aktiviteti u pasqyrua

në një nga revistat e përjavshme italiane më të lexuara të kohës "L'illustrazione italiana". Më 15 shkurt 1902. Ismail Qemali, së bashku me eksponentë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si Ibrahim Temo, Dervish Hima, Jashar Erebara etj., u përfshinë në lëvizjen e Turqve të Rinj (Xhonturqve), duke pasur parasysh synimin e kësaj lëvizjeje për rivendosjen e kushtetutës së vitit 1876. Ata e shikonin atë si një mundësi për të realizuar të drejtat kombëtare shqiptare.

Dervish Hima ishte bashkëpunëtor i Ibrahim Temos dhe u udhëzua prej tij të shkruante në revistat xhonturke, me synimin për të arritur pajtimin midis xhonturqve dhe kundërshtarëve shqiptarë të sulltanit. Elita politike shqiptare besonte se Revolucionin Xhonturk do ta zgjidhte çështjen e statusit politik të shqiptarëve në Perandori. Shqiptarët e mirëpritën me entuziazëm shpalljen e Monarkisë së Dytë Kushtetuese dhe e konsideruan formën e re të qeverisjes si fillim të reformave që do të rezultonin me njohjen e autonomisë së Shqipërisë. Projekti xhonturk nuk synonte demokratizimin e shoqërisë osmane, por mbrojtjen e shtetit osman, duke imponuar otomanizmin, si një përpjekje për të zhdukur veçoritë kombëtare të popujve. Meqenëse kjo përpjekje u pa si e dështuar që në fillim, xhonturqit iu kthyen fesë si mjet për të ruajtur kohezionin shtetëror, duke mos lejuar që prirjet nacionaliste të manifestuara të kombësitë e krishtera të ndikojnë edhe te kombësitë myslimane të Perandorisë si te: shqiptarët, arabët, kurdët, etj. intelektualët shqiptarë si Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Ibrahim Temo, Dervish Hima etj., u përpoqën që t'i bindin xhonturqit se midis shtetit osman dhe shqiptarëve ka interesa të përbashkëta, mbi bazën e të cilave duhet të vazhdojë bashkëpunimi, që shqiptarët të mbeteshin shtyllë e shtetit osman, siç përmendeshin ata dhe në të kaluarën, duke ua njohur atyre të drejtat kombëtare, njësoj me kombësitë e tjera.

Rivendosja e kushtetutës osmane lejoi që të mërguarit politikë, ndër ta dhe Dervish Hima, të ktheheshin në atdhe. Në gazetën e tij "Shqiptari" Hima theksoi rëndësinë e identitetit dhe gjuhës shqipe, duke i parë ato si dy anë të së njëjtës medalje. Ai theksoi se botimi i gazetës "Shqiptari" kishte për qëllim ndriçimin e shqiptarëve, ngritjen e nivelit të tyre të intelektit dhe kulturës, së bashku me inkurajimin e bashkëpunimit dhe të kuptuarit e osmanizmit, sistemit osman, perandorisë dhe popujve të saj në lidhje me ta. Gazeta "Shqiptari" u përdor nga Hima për t'iu drejtuar qeverisë osmane dhe për t'i mbajtur problemet shqiptare brenda sferës publike. Gazeta e tij kishte publikuar peticione dhe letra nga shqiptarët dhe deputetët shqiptarë të parlamentit osman për çështje të tilla alfabeti i shqipes. Për qëndrimet që mbante, xhonturqit i organizuan një atentat të dështuar në Korçë, si dhe e mbajtën për tetë muaj në burg. Pas lirimit, ai kaloi në një turne shtatëmuor në Shqipëri, ku mbajti konferenca të ndryshme në klubet shqiptare të vendbanimeve që vizitoi.

Në ato konferenca Hima theksoi sakrificat dhe kontributet shqip-

PESONALITETE TË ARSIMIT

MËSUESI I POPULLIT, SELIM ALLIU

PROF.DR. HAJRI SHEHU

Selim Alliu lindi në katundin Strikçan të qarkut të Dibrës (1914). Mbaroi shkollën fillore në Zerqan dhe pastaj shkollën plotore në Kastriot. (Shkolla qe hpur më 1924). Pas shkollës plotore, Selimi është nxënës në shkollën normale të Elbasanit. (Normalja e Elbasanit qe hapur më 1909). Në shkollë, Selimi u shqua si dashatar i letërsisë. Bënte hartime të bukura. Dhe e zgjodhën anëtar të redaksisë së revistës “Normalisti”, bashkë me Sterjo Spasen e disa të tjerë. Revista ishte e shkollës.

Pas mbarimit të Normales, Selimin e caktojnë mësues në fshatin Pepel të Libohovës. Më pas, në Trebisht të Dibrës. Në vitin 1937-1938 e emërojnë mësues në shkollën ushtrimore të Normales. Emërimi në atë shkollë erdhi nga Ministria e atëhershme e Arsimit. Ishte vlerësim i lartë. Ushtrimorja ishte shkolla fillore ku normalistët, mësuesit e ardhshëm, bënë praktikën mësimore. Kjo do të thotë që mësuesit e ushtrimore zgjidheshin si më të mirët. Në vitet 1940-1942 është inspektor i arsimit në qarkun e Dibrës. Më 1942-1944 është inspektor



i arsimit në Dibër të Madhe. Çlirimi i vendit e gjeti mësuesin Selim Alliu në Peshkopi: shef i Seksionit të arsimit të qarkut. Atëherë, në qarkun e Dibrës kishte 59 shkolla fillore e 62 mësues. Asnjë shkollë unike. Analfabetizmi – si kudo në Shqipëri. Me përpjekjet e shefit të arsimit, Selim Alliu, u hap në Peshkopi e para shkollë unike (1

dhjetor 1945). Pastaj, siç dihet, vendi u mbush me shkolla. Arsimi u masivizua. Më 1948 u hap shkolla pedagogjike në Peshkopi. Në vitet ’60 – shkolla e mesme bujqësore e shkolla të tjera të mesme me profile të tjera pa shkëputje nga puna. Në vitin 1964 – shkolla 12-vjeçare. Më pas – gjimnazi i Peshkopisë. Deri në vitin shkollor 1964-1965, në krye të këtij zhvillimi arsimor qe Selim Alliu, Mësuesi i Popullit, mësuesi i mësuesve të Dibrës.

Thashë vetëm këto pak fjalë për mësues Selim Alliu. Ato janë ca copëza për një personalitet të madh të arsimit. Janë copëza që tregojnë shumë. Janë copëza dashurie dhe respekti.

Selim Alliu e gdhendte fjalën. I kam dëgjuar raportet e tij në mbledhjet e përgjithshme vjetore me arsimtarët e rrethit. E kam dëgjuar në takime të tjera me arsimtarët. E kam dëgjuar në këshillin pedagogjik të gjimnazit. Kisha menduar se një njeri i tillë nuk mund të ketë bërë raporte e referate vetëm për arsimtarë e komitete ekzekutive. Po “për vete” a ka shkruar?, - mendoja. Dhe iu vura kërkimit. Zgjodha kohën e shkollës së tij në Normalen e Elbasanit. Dhe shfletova në bib-

liotekën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të gjithë numrat e revistës “Normalisti” dhe gjeta disa. Shkruante adoleshenti dhe rinoshi Selim Alliu. Dhe shkruante bukur. Unë u gëzova për këto gjetje dhe po me atë gëzim ia dhashë Samiut (Sami Shehut). Samiu është ai që ka qenë aq pranë Selim Alliu. Samiu do të bënte librin për Selim Alliu. Përsëri mendova dhe them tani: Sikur ta kishin lënë të shkruante, por jo raporte e referate, Selimi do të kishte qenë shkencëtar, etnograf, shkrimtar. Anë. Nuk është më pak se i tillë. Ka udhëhequr arsimin në Dibër për më shumë se 20 vjet. Me rezultate të shkëlqyera. Dhe, le të shkruajnë të tjerët atë që kanë dëgjuar e kanë parë nga mësues e shef Selimi se është sikur t’i kishte shkruar vetë ai. Nuk ka fshat ku të mos ketë shkelur Selim Alliu. Nuk ka arsimtar që të mos e ketë njohur Selim Alliu. Dhe, sikur të mblidheshin copëza shkrimi nga të gjithë ata, do të krijohej një thezim (mozaik) i madh, shumëngjyrësh, i ndritshëm, i bukur fort. Do të ishte jeta e gjallë e Selimit.

Do të jetë vetë Selimi: Mësuesi i mësuesve të Dibrës.

DERVISH HIMA DHE ZENEPE HIMA (QOKU), KONTRIBUT MADHOR PËR CËSHTJEN KOMBËTARE DHE GJUHËN SHQIPE

Vijon nga faqja 12

tare për Perandorinë, pretendoi se Shqipëria ishte “djepi i lirisë” dhe mbrojti përdorimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit nga malësorët shqiptarë. Ai kërkoi bashkimin e shqiptarëve në një vilajet, shkolla ku të mësohej edhe gjuha shqipe, që shqiptarët të kryenin shërbimin ushtarak brenda territoreve shqiptare në Ballkanin osman. Gjatë udhëtimit nëpër trevat shqiptare, Hima punoi aktivisht për krijimin e komiteteve të fshehta. Si rezultat i udhëtimeve të tij në Manastir, ai organizoi ngritjen e komiteteve të fshehta në çdo rajon të Manastirit.

Në vitin 1909, ishte në grupin organizator të themelimit të shoqërisë “Vëllazëria” në Elbasan, ku qëllimi i dukshëm i shoqërisë ishte popullarizimi i gjuhës shqipe, por qëllimi kryesor i saj ishte të nxiste ngritjen e komiteteve të reja të fshehta në Shqipëri. Dervish Hima ishte pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, si njëri nga përfaqësuesit e forcave atdhetare të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ku doli qartë kërkesa e për zhvillimin e jetës kulturore të shqiptarëve në mënyrë të pavarur nga turqit. Hima dallohet ndër oratorët shqiptarë, i cili ndikoi që Kongresi të merrte kohen e duhur, krahas Haxhi Vehbi Dibrës, Hafiz Ali

Korçës, Jusuf Bej Karahasanit, Fehim Zavalanit shumë të tjerëve.

Për shkak të reaksionit xhonturk, Hima kaloi nga Konstanca e Rumanisë në Stamboll më 18 dhjetor 1909 dhe u vendos në lagjen Beyoğlu, ku vazhdoi me botimin e gazetës “Shqiptari”, të cilën ua dërgonte abonentëve të tij në Shkup dhe Manastir. Ai shkroi shumë artikuj për gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare, duke dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e vetëdijes kombëtare te shqiptarët. Mori pjesë në Kongresin e Dytë i Manastirit, që i zhvilloi punimet më 2-3 prill 1910. Në fjalën e tij, ndër të tjera ai kishte theksuar: “Armiktë na kanë çelur luftën në fushën e shkronjave, ne do t’i mbajmë dhe do t’i mbrojmë shkronjat tona kombëtare me mish e me shpirt”.

Më 13 dhjetor 1910 Hima ngriti shqetësimet për “militarizimin” osman, për emërimin e oficerëve të ushtrisë në postet e administratës civile në Shqipëri, në vend të burokratëve të kualifikuar dhe protestoi ndaj përdorimit të forcës për të zgjidhur problemeve lokale. Gazeta “Shqiptari” u mbyll në fund të vitit 1910, si pjesë e fushatës më të gjerë të qeverisë osmane kundër alfabetit dhe shkollave shqipe me alfabet latin. Pas mbylljes së kësaj gazete, gjashtë numra të saj, nga numri 34 deri në numrin 39 u botuan me emrin “Bashkimi” dhe, pasi u hoq

ndalimi i botimit, ai vazhdoi ta botonte sërish me emrin “Shqiptari” në numrin e 40, që mban datën 13 dhjetor 1910.

Edhe pas vendosjes në Stamboll, Dervish Hima vazhdoi aktivitetet e tij politike, duke shkruar herë pas here në atdhe, por edhe duke udhëtuar jashtë, ku në gjysmën e dytë të 1911 kishte vizituar Bukureshtin dhe Vjenën. U kthye në Stamboll në muajt e parë të vitit 1912 dhe vazhdoi veprimtarinë e tij politike dhe kaloi edhe në Shqipëri.

Veprimtaria e Dervish Himës në periudhën parakushtetuese u mbështet nga Perandoria Austro-Hungareze, e cila vazhdoi ta mbështeste edhe pas shpalljes së Monarkisë Kushtetuese. Së pari, në prill 1910, nga përfaqësuesi austriak iu bë një ofertë që Vjena do të financonte të gjitha shkollat që ai do të hapte në trevat shqiptare. Në janar 1912, Dervish Hima kërkoi mbështetje për financimin e gazetës dhe udhëtimet e tij në Manastir, Janinë dhe Kosovë.

Kur shpërtheu kryengritja e vitit 1912 organizoi kryengritjen në Ohër dhe Manastir; shkoi në Korfuz dhe filloi punën për përhapjen e rebelimit në jug të Shqipërisë. Ishulli i Korfuzit, nën sundimin grek, ishte kthyer në një strehë të sigurt për kryengritësit shqiptarë, si rezultat i avantazhit strategjik që ofronte afërsia me Janinën. Përmes ishullit kryheshin edhe dërgesa armësh në pjesë të ndryshme të Shqipërisë.

Në fund të majit 1912, për të bërë organizimin e kryengritjes, Dervish Hima kishte kaluar në Prevezë, Pargë e në Vlorë. Si rezultat i veprimtarisë së tij dhe të drejtuesve të tjerë, komitetet e fshehta të Manastirit, të Korçës, të Vlorës, të Beratit e të Elbasanit u betuan se do të mbështesnin veprimet luftarake në Vilajetin e Kosovës..

Në ditën e shpalljes së Pavarësisë, Dervish Hima mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe ishte një nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe u zgjodh anëtar i Pleqësisë.

Pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar mbeti i angazhuar ndaj çështjes kombëtare, pjesëmarrës në Kongresin e Triestës që u mbajt nga 27 shkurti me 6 mars 1913 së bashku me Hamdi Bej Ohër, Sotir Kolean dhe Faik Konicën, kongres që kishte në qendër të vëmendjes njohjen e qeverisë së Ismail Qemalit dhe moscopëtimin e vendit. Pas përzënies së serbëve, autoritetet austro-hungareze e kishin emëruar Dervish Himën inspektor Arsimit në Tiranë, në vjeshtën e vitit 1917.

Pas konsolidimit të shtetit shqiptar, me shpalljen e Republikës, Dervish Hima qe emëruar Drejtori i parë i Drejtorisë së Shtypit të Presidencës së Shqipërisë. Vdiq në Tiranë më 13 prill 1928, në moshën 56 vjeçare.

IN MEMORIAM

Krahas emrit të piktorit shijakas Agim Faja, etj. si ilustrator i nderuar, u rreshtua edhe Musa Qarri

NJË ALBUM ME VEPRËN DHE SHPIRTIN E PIKTORIT MUSA QARRI

SHPENDI TOPOLLAJ

Edhe pse shumë rrallë shfaqej në veprimtari të ndryshme, në mediat e shkruara apo ekranet e TV, emri i Musa Qarrit gjithmonë përmendej me respekt të veçantë, si në qytetin e Kavajës ku kaloi pjesën më të madhe të jetës qysh nga lindja në vitin 1943, apo në Durrës, ku u vendos pas viti 97 - ë, ashtu edhe në të gjithë Shqipërinë. Dhe kjo, jo vetëm sepse ai ishte njeri dhe intelektual me vlera të larta, por se kontributi që ai dha në profesionin e piktorit - grafist, ka qenë aq i madh dhe cilësor, madje do të thoshja edhe i veçantë, sa edhe ata që nuk e kanë takuar personalisht ndonjëherë, e kanë njohur nga revistat, gazetatat, librat dhe ekspozitat e tij të shumta.

Tani që ai artist i dashur për të gjithë, u nda nga jeta, mbetet sërish i pranishëm, falë përmbledhjes së veprave kryesore të tij, në një album dinjitoz, botuar shtatë vjet më parë nga Shtëpia Botuese EMAL e drejtuar nga miku i tij, kavajasi Astrit Muça.

Ndofta është më e lehtë që ta kërkoj suksesin në artin e të pikturuarit të ngjyrat, sikurse kanë bërë shumica e piktorëve ndër shekuj. Por kuptohet se kërkon shumë mjeshtëri arritja e këtij sukcesi në grafikë, ku kryesisht operohet me dy ngjyra në dukje përjashtuese; bardhë e zi dhe ku përsosmërisë dhe harmonisë nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e veçantë.

Dhe ja, pikërisht këtij arti i dha më shumë hapësirë, pas rekomandimit të pedagogut të tij, që e kanë quajtur mjeshtër i peizazheve kubiste, Ksenofon Dilo, edhe Musa Qarri. Ai e kishte të qartë se në artin e grafikës, i gjithë përqendrimi i artistit duhet të ishte te vërtetësia e asaj që pasqyrohet, mesazhi ndofta dhe i fshehur që do të jepte, dhe te kultura e cila ishte garancia e vetme e kompozimit me fantazi. Dhe ai i kishte të plotë këto cilësi.

Duke qenë bir i kartoleristit të parë të qytetit, ku shiteshin librat e të gjitha llojeve, në familjen e tij ishte krijuar një mjedis intelektual i dallueshëm. Më vonë, pas kryerjes së studimeve në shkollën e mesme artistike “Jordan Misja” dhe më pas në Institutin e Lartë Arteve në kryeqytet, Musai pati fatin të punojë si piktor - grafist në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, ku ju dha mundësia të bëhet ilustrator i dhjetra e dhjetra librave të autorëve tanë e të huaj. Krahas emrit të piktorit shijakas Agim Faja, etj. si ilustrator i nderuar, u rreshtua edhe Musa Qarri.

Duke iu referuar veprave që kanë zënë vend në këtë album, mund të themi se krijimtaria e tij në fushën e grafikës, ndahet në dy faza: ajo e periudhës së realizmit socialist dhe ajo kur si kushdo, edhe artistët patën mundësinë të dalin nga kornizat kufizuese dhe ta tregojnë të plotë talentin e tyre.

Përsa i takon periudhës së parë, përveç qëndrimit besnik ndaj tematikës së kohës, si fjala vjen Elektrizimit (cikël me të cilin mbrojtja diplomën), kooperativave bujqësore, punëtorëve nëpër fabrika, ushtarëve në mbrojtje të Atdheut, dashurisë së të rinjve duke mbajtur distancën “morale”, lavdisë partizane, bollëkut në korjen e grurit dhe kapjen e peshkut apo vjeljen e duhanit, entuziazmit të aksioneve, kënaqësisë për të shkruar në punë me lopatë në dorë pa zbardhur dita, valleve popullore me opinga, brekushe e qeleshe, na shfaqen edhe shumë portrete, kryesisht fshatarësh. Duhet thënë se askush deri më sot, nuk është marrë me fshatin dhe fshatarët si Musa Qarri. Duket dashuria e tij e madhe për njerëzit e thjeshtë, punëtorë e të ndershëm, çka e tregon edhe çelja nga ana e tij e ekspozitave vetjake në Synej, Kryevidh, Helmës dhe Kavajë, pa folur për ato në Tiranë apo Durrës etj. Por të jemi të drejtë: nuk ka sesi të mos bjerë në sy edhe zhgënjimi i tyre, varfëria e deri dëshpërimi.

Dihet që disa vepra të tijat, të cilësuar si me ndik-



- *Duke qenë bir i kartoleristit të parë të qytetit, ku shiteshin librat e të gjitha llojeve, në familjen e tij ishte krijuar një mjedis intelektual i dallueshëm. Më vonë, pas kryerjes së studimeve në shkollën e mesme artistike “Jordan Misja” dhe më pas në Institutin e Lartë Arteve në kryeqytet, Musai pati fatin të punojë si piktor - grafist në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, ku ju dha mundësia të bëhet ilustrator i dhjetra e dhjetra librave të autorëve tanë e të huaj*

ime moderne, nuk u ekspozuan ndonjëherë, por nuk do të ishte çudi, për zhdanovizmin e kohës që atij të mos i pranoheshin shumë e shumë nga krijimtaria e tij për arsye “ideologjike”, pasi ai nuk na i jep të “bukur” fshatarët as në grup dhe as kur bën portretet e tyre të veçanta. Sot ato marrin përmasa dhe vlerësimë shumë më të mëdha, pasi na e japin besnikërisht kohën kur gënjeshtria dhe demagogjia ishin në rend të ditës edhe në art. Ndofta që i pari vetë Van Gogh ai që nuk e kurseu në portret as mikun e tij, për të mbërritur kulmin me Edvard Munch. Profesori i nderuar Kujtim Buza kujton se Musai qysh student joshej nga krijimtaria e gjermanes Kathe Kollëitz, që admironte të varfërit, Franc Mazarelit apo meksikanëve të shquar në grafika, që i gjente atje në bibliotekën e Institutit.

Po të shohësh grafikën e tij “Druvari”, “Nxënësit e varfër”, “Mjerimi” (1973 dhe tjetra 1975), “Mësuesi i dëshpëruar”, “I pashpresë”, “I revoltuari”, “Duam bukë”, “Roja i kooperativës” etj. nuk je në gjendje të dallosh se cilës kohë i referohen, pasi ato ishin pjesë e qënësishme edhe e realitetit socialist. Sjell në kujtesë veprën në skulpturë të Ernst Balach i cili jetoj edhe pesë vjet pas ardhjes në pushtet të nazizmit, me titullin “Mëshirë”, ku duart kockë e lëkurë të lypses, të skalitura qysh në 1919, janë të vlefshme për çdo kohë.

Në periudhën e dytë, pra pas viteve 90 - të të krijimtaria e Musa Qarrit bije në sy simbolika. Ka aty me bollëk art modern, bashkime në dukje të habitshme, por që të bëjnë të vrasësh mendjen dhe mbi të gjitha, daljen në pah të shpirtit të tij të lirë. Tani ka të tjera zhvillime, ndaj arti nuk ka mëshirë për kërkënd apo drojë nga askush. Kështu, ja vlen të tallesh si te “Vallja e tufëzimit” ku jo vetëm lopëve, por edhe njerëzve u kishin dalë brinjët nga mosushqyerja nën hijen e parrullës “Rrot sh Enver”, dhe më tej, ka edhe grafika nga aktualiteti, krijuar me çdo teknikë që pranon, ajo: “Kavaja, lokomotiva e demokracisë”, “Ikje nga skëterra”, “Maskat”, “Rrëmbyesit e diellit”, “Guri i rëndë në vend të vet”, etj., por ka edhe shumë tablo me ngjyra, ku përfundimisht kupton se autori është i pajisur me dije të thella. Kjo vërehet menjëherë te figura në role e kavajasit emërmadh Aleksandër Moisiu, te vepra të ndryshme teatrale, te piktori - filozof i njohur për aforizmat e tij të mençura, mauriciani Malcolm de Chazal (1902 - 1982), te cikli me ilustrime të novelës së Viktor Ridit “Leopardi” apo edhe në fragmente nga mitologjia, si Sizifi. Kjo pjesë e krijimtarisë së tij ende e padeshifruar në modernitetin e tij të pakoduar, sipas shkrimtarit erudit të Kavajës që u largua shpejt nga jeta Abdulla Tafa, mbetet ende për t’u diskutuar nga ana e kritikëve të mirëfilltë të artit.

Një nismë të tillë e ka ndërmarrë me sukses piktori Muhamed Malilaj i cili ka analizuar me dashuri dhe kompetencë profesionale disa nga veprat e tij, analiza të përfshira në faqet e këtij albumi, sikurse kanë dhënë konsideratat e tyre edhe plot piktorë apo shkrimtarë të tjerë, miq të tij si Abaz Hado, Nazmi Roli, Durim Çaçë, Gëzim Kabashi, Stefanaq Sotja. Dhe të gjithë theksojnë se Musa Qarri, përveç se një piktor - grafist i përmasave kombëtare, ishte mbi të gjitha një njeri me shpirt të madh e të ndjeshëm, që e donte vendin dhe popullin e tij me gjithë zemër, një artist që e kërkonte dhe e gjente në çdo kohë e në çdo rrethanë të bukurën. Një artist që zbatonte porosinë e pavdekshme të Mike-lanxhelos se “Pikturohet me tru e jo me duar”.



ANALIZË

MINISTRJA SERBE SNEZANA PAUNOVIÇ ËSHTË HIENA E VASO ÇUBRILLOVIÇIT

Nga Sefer Pasha

Nuk kam shumë ditë që jam kthyer nga Drenica e Pashës. Zi ka në çdo shtëpi, mëhallë, fshat e qytet. Janë qindra dhe mijëra të vrarë e të zhdukur. Nuk ka asnjë lajm për rrëmbimin e profesor Ukshin Hotit qysh në 16 maj të vitit 1999. Po a i njej ministria serbe krimet e Millosheviçit? Ja disa prej tyre. Në Kruhën e Vogël janë rrëmbyer e më pas janë zhdukur rreth 70 përqind e meshkujve që nga moshë 13 vjeçare deri në moshën 77 vjeçare. 83 gra kanë mbetur të veja. 113 burra e djem i mblodhën në një vend, i ekzekutuan dhe kufomat e tyre i dogjën dhe i hodhën në Drin. 270 burra janë vrarë në Krushën e Madhe. 352 burra në Korenik, 81 në Celinë, 36 në Trinjë e lista nuk ka të sosur. Në luftën e fundit të udhëhëqur nga Millosheviçi makinat frigoriferike mbusheshin me kufoma në Reçak, në Prizren e në disa vende të tjera, ku ishin bërë masakra dhe kufomat zbraseshin në lumin e Danubit. Kur kosovarët masakroheshin ata nuk bënë ndaj serbëve asnjë rezistencë. Nuk i kundërshtuan me armë milicët dhe ushtarët e Millosheviçit.

Por që të jemi singëlë me ministrin serbe që kërkon të bëjë spastrimin etnik të ri po i tregoj vetëm një krim të kosovarëve. Gjatë luftës të vitit 1999 në një fshat rrëzë Drinit të Bardhë jetonte një plak e cila kishte shërbyer si mami në disa fshatra. Kur Kosova po spastrohej prej Millosheviçit ushtarët serb përdhunuan në sy të burrave me dhjetra femra të bukura kosovare dhe i lanë shtatëzana. Këto gra fatkeqe shkonin tek mamia plak dhe aty ajo u bënë abort. Kufomat e foshnjave i hidhte nga shkëmbi në Drin. Ajo nuk mund t'i linte femrat kosovare, që ato pa burra të rrisnin fëmijët e serbëve. Po kjo nepërka me dy kokë Snezana Paunoviç mendon që në një gjenocid të ri kosovarët do ta ulin kokën. Jo. Pushkët dhe mitralozët e kosovarëve do të zbrasen brenat në Beograd. Dhe në kopshtin e minstres që tmerrojnë dynjanë me deklaratën e saj sakandaloze do të hidhen bomba.

.....Ju Snezana Paunoviç u shfaqët këto ditë si Vaso Çubrilloviçi. Ja çfarë thoshte idhulli yt Çubrilloviçi: - “Në hartën bashkëngjitur shihet se cilat rrethe duhet të shpërngulen. Këto janë: - Dibra e Sipërme, Pollogu i Poshtëm, Pollogu i Sipërm, Mali i sharrit, Drenica, Peja, Istogu, Vuçiterna, Stavica, Llapë, Graçanica, Gjakova, Gora, Podrimja, Gjilani dhe Kaçaniku”. Libri “Shpërngulja e shqiptarëve” i Vaso Çubrilloviçit u paraqit në klubin e Kulturës në Beograd më 7 mars 1937. Këtë libër ju e mbani si Bibël në zyrën tuaj. Thonë se e lexoni me ngazëllim dallditës.Nuk e di se me çfarë epiteti t’ju flas e t’ju shkruij emrin se ju kohët e fundit kur folët për një spastrim të ri të kosovarëve u shfaqët dhe si një narciste. Kështu nuk flet në mes të Evropës një ministre. Ju nuk jeni ministere, por një hienë. Po të kujtoj dhe ndonjë krim të vjetër. Në Gjakovë serbët kishin zhdukur një fis të madh. Kishte shpëtuar një çift i ri të martuar. Çifti gjakovar u ngjii në mal. Dhe një jetë të tërë udhëtoj në male e në bjeshkë. E ushqenin bjeshkëtarët. Çifti nga Gjakova lindi disa fëmijë. Këto fëmijë u rritën dhe u martuan udhëve me malsor të tjerë. Më në fund çifti u plak dhe pyeti një mëngjes ca kositës bar, por ata nuk dinin shqip. Çifti gjakovar aty mori vesh se duke udhëtuar për 50 vjet mal më mal ata kishin mbrtur në bjeshkët e Bullgarisë. Më në fund çifti u kthye në Gjakovë. Por aty ata u çuditën. Gjetën lagje të reja, pyje të paprerë, liqene me zambak, ujvara të egra, gratë bënë nga tre fëmijë, tufa me dhi të egra, zjarre të pashuar, kroje nëpër shkëmbinj, uzi-na e fabrika dhe ura ku kurrë nuk kishte pasur lumenj. Gjithçka kishte ndryshuar. Një gjë ishte si dikur. Serbët si një herë e një kohë i përndiqnin kosovarët. I burgosnin dhe i vrisnin. Ishte e njehta pamje Kam përgatitur për ty Snezana Paunoviç një album me fotografi. S’besoj se do të trish-tohesh. Është gjetur një fotografi në vorrezën e Reçakut. Në foto duket një fëmijë i

vdekur me biberon në gojë.

Ai është në krah të nënës së vrarë nga milicët serb. Kurse në një tjetër fotografi shihet një tufë me çakenj të cilët tërheqin zvarr kosovar gjysëm gjallë e gjysëm vdekur. Gjithashtu në faqet e albumit do të shohësh varrezë masive me kufoma të djegur. Shfaqet një nuse e hipur në kal me dhëndrrin që e masakrojnë milicët serb. Sheh besimtar të varë në xhaminë e Prizrenit. ushtarët serb djegin arat me grurë dhe burra të ciët i tërheqin vet parmendat kur bëhen mbjelljet e pranverës. Është për të vënë duart në kokë kur do të marësh vesh nga albumi që vijës së kufirit në tokën e Serbisë, ku nuk ka asnjë fshat, por ka varreza. Trupat e Millosheviçit i kanë marrë kosovarët e vdekur dhe i kanë varrosur në teritorin e Serbisë, ku nuk ka asnjë fshat serb. Lajmi dramatik se ministria serbe për Kosovën Snezana Paunovic ka deklarur në Beograd me cinizëm se Millosheviçi ka përgjegjësi që në vitin 1998 nuk e spastrojë të gjithë Kosovën nga shqiptarët mua gjetë në ullahtat e Vlorës ku avash - avash ulëri kalinjtë po piqet. .Po të njoh moj ministere e Vuçit me një zog që quhet Gergu. Ai fluturon që nga Serbia dhe gjatë gjithë vjeshtës ushqehet me ullinjtë e pjekur të Vlorës. Zogu Gerg që vjen nga Serbia është sa një pulë. Ai ka mish të mirë si të thellëzës, por gjahtarët e Vlorës edhe pse e vrasin nuk e hanë. E flakin si të jetë mish korbi. Pyes dhe gjahtarët më përgjigjen se Gergun ata nuk e hanë se serbët kanë bërë krime në Kosovë.

.....Tani jam i detyruar që të citoj tragjeditë e shkatuara nga milicët e Millosheviçit. Juristi Agron Limani u torturua me Ukshin Hotin. Atij kriminelët i vranë të atin Nebiun 58 vjeç, vëllain Luanin 22 vjeç dhe xhaxhain Limanin me të birin invalid që quhej Avdyll. Juristi Agron Limani i ka mbledhur dhe noterizuar çdo gjë që ka ndodhur. I ka paraqitur dhe në Prokurorinë e Kosovës.

Ja emrat e viktimave të masakruar në Krushën e Vogël fiks në datën 26 mars 1999. Janë plot njëqind e dhjetë vetë. Ja dhe emrat. **Isni Elez Rashkaj, Nazmi Elez Rashkaj, Demir Nazmi Rashkaj, Kadri Nazmi Rashkaj, Refik Sadik Rashkaj, Ahmet Manush Berisha,Ramadan Jup Ramadan, Sabit Hysen Ramadan, Liman Hazer Limani, Avdyll Liman Limani, Nebi Hazer Limani, Luan Nebih Limnai, Adem Isuf Asllani, Asim Adem Asllani, Feim Adem Asllani, Muharrem Isuf Asllani, Nusret Muharrem Asllani, Nexhat Muharrem Asllani, Murat Bajram Ramadan, Salajdin Murat Ramadan, Afrim Lutfi Ramadan, Bajram Lutfi Ramadan, Shani Mahmut Hajdari, Halil Mahmut Hajdari, Hysni Mahmut Hajdari, Hysni Halil Hajdari, Qamil Mahmut Hajdari, Zenun Qamil Hajdari, Sait Mahmut Hajdari, Abaz Abedin Hajdari, Abedin Abaz Hajdari, Halim Abaz Hajdari, Salajdin Halim Hajdari, Nazim Halim Hajdari, Rasim Halim Hajdari, Vesel Halim Hajdari, Mursel Halim Hajdari, Bali Avdyll Avdyli, Enver Bali Avdyli, Avdi Bajram Batusha, Enver Avdi Batusha, Visar Avdi Batusha, Asllan Islam Batusha, Syl Sadik Batusha, Bekim Syl Batusha, Muharrem Dervish Batusha, Begir Dervish Batusha, Njazi Begir Batusha, Zaim Qazim Batusha, Feim Zaim Batusha, Mërgim Zaim Batusha, Ahmet Qazim Batusha, Burim Ahmet Batusha, Lirim Ahmet Batusha, Milaim Qazim Batusha, Haxhi Rasim Batusha, Sejdi Mehmet Batusha, Amrush Sejdi Batusha, Osman Mehmet Batusha, Skyfer Osman Batusha, Hysen Magjum Zylfiu, Nazim Hysen Zylfiu, Afrim Hysen Zylfiu, Hamdi Dalip Zylfiu, Hamit Hamdi Zylfiu, Halim Haxhi Zylfiu, Xhelal Halim Zylfiu, Nikoll Shyt Prenkaj, Nue Shyt Prenkaj, Sejdi Haxhi Emrullahu, Nuredin Qazim Shehu, Sefer Nuredin Shehu, Fadil Nuredin Shehu, Xhafer Nuredin Shehu, Vesel Fadil Shehu, Visar Fadil Shehu, Adnan Sefer Shehu, Ajvaz Nuredin Shehu, Xhelal Sefer**

Shehu, Ismail Arif Shehu, Arif Ismail Shehu, Ismet Ibrahim Shehu, Mentor Ismet Shehu, Haxhi Avdyll Shehu, Arben Sadik Shehu, Destan Haki Shehu, Shefqet Destan Shehu, Aziz Haki Shehu, Sami Haziz Shehu, Selami Haziz Shehu, Miftar Haki Shehu, Nehat Miftar Shehu, Mehmet Miftar Shehu, Shani Qamil Shehu, Veli Qamil Shehu, Sali Shyqyri Shehu, Sahit Sali Shehu, Reshat Shyqyri Shehu, Bekim Reshat Shehu, Dervish Shyqyri Shehu, Raif Shyqyri Shehu, Nexhat Shyqyri Shehu, Xhavit Sali Shehu, Driton Sali Shehu, Nait Sali Shehu, Kujtim Reshat Sheu, Burim Refat Shehu, Flammur Reshat Sheu, Sinan Faik Shehu, Muhamet Ajat Emrullahu. Gjithashtu po i përcjell lexuesit emrat e grave të Krushës së Vogël, të cilat humbën njerëzit e tyre të dashur. Ja lista me pamjen e saj të zezë: -1)Nexhmije Hajdari ka humbur pesë djem. 2)Aishe Shehu, bashkëshortin dhe katër djem. 3)Qerime Asllani, bashkëshortin dhe dy djemtë. 4)Mejdie Shehu, bashkëshortin dhe dy djemtë. 5)Hatixhe Asllani, bashkëshortin dhe tre djemtë. 6)Xhyferie Limani, bashkëshortin dhe djalin.7)Kimete Limani, bashkëshortin dhe djalin. 8) Shukrie Limani, bashkëshortin. 9) Vjollca Asllani, bashkëshortin. 10) Miserete Asllani, bashkëshortin. 11) Zyra Asllani, bashkëshortin. 12)Softje Rashkaj, djalin. 13)Zahrije Rashkaj, bashkëshortin dhe dy djemtë. 14)Lumturie Asllani, bashkëshortin. 15)Eddie Shehu, bashkëshortin. 16)Xhyferie Shehu, bashkëshortin.17)Hanëmshahe Batusha, tre djem dhe pesë nipa. 18)Hyrisahe(Sefer) Shehu, bashkëshortin dhe dy djemtë. 19)Nurie Rashkaj, bashkëshortin. 20)Fatime Shehu, bashkëshortin dhe dy djemtë. 21)Myvedete Shehu, bashkëshortin. 22)Serbeze Shehu, bashkëshortin. 23)Merita Shehu, bashkëshortin. 24) Lirie Shehu, bashkëshortin. 25)Resmije Shehu, bashkëshortin. 26)Nesibie Shehu, bashkëshortin. 27)Vjollca Sheu, bashkëshortin. 28)Miserete Ramadani, bashkëshortin. 29)Miradije Ramadani, dy djemtë. 30)Xhyferie Ramadani, bashkëshortin dhe djalin. 31)ZylfieBatusha, bashkëshortin dhe djalin. 32)Afërdita Ramadani, bashkëshortin. 33)Hajrie Shehu, bashkëshortin. 34) Sakibe Berisha, bashkëshortin dhe djalin. 35)Havni-je Hajdari, bashkëshortin. 36)Selvete Hajdari, bashkëshortin. 37)Shkurte Hajdari, bashkëshortin. 38)Drita Hajdari, bashkëshortin. 39)Sadije Hajdari, bashkëshortin dhe djalin. 40) Fetije Hajdari, bashkëshortin. 41) Zamide Hajdari, bashkëshortin. 42) Hida-jete Hajdari, bashkëshortin dhe djalin. 43)Qelebie Hajdari, bashkëshortin dhe djalin. 44)Shkurte Hajdari, bashkëshortin. 45)Akile Zylfiu, bashkëshortin. 46)Figerie Zylfiu, bashkëshortin dhe vjehrrin. 47)Drita Batusha, bashkëshortin dhe vjehrrin. 48)Vezire Batusha, bashkëshortin dhe dy djemtë. 49)Atije Shehu, bashkëshortin dhe tre djemtë. 50)Akile Batusha, bashkëshortin dhe dy djemtë. 51)Shemsie Batusha, bashkëshortin. 52)Hyrmete Batusha, bashkëshortin. 53) Zahrije Batusha, bashkëshortin. 54)Letafete Batusha, dy djemtë dhe dy nipa. 55)Nexhmije Batusha, bashkëshortin dhe dy djemtë. 56) Xhylije Batusha, bashkëshortin. 57) Burbuqe Batusha, bashkëshortin. 58)Xhyli-ferie Batusha, bashkëshortin dhe djalin.59)Lumnije Ramadani, bashkëshortin. 60)Nazmije Ramadani, bashkëshortin dhe djalin. 61) Elfete Ramadani, bashkëshortin. 62) Kade Ramadani, bashkëshortin. 63) Roze Prenkaj, bashkëshortin. 64)Zojë Prenkaj, bashkëshortin. 65)Shukrie Shehu, bashkëshortin. 66)Sanije Shehu, bashkëshortin. 67)Flurie Shehu, bashkëshortin. 68)Figerie Shehu, bashkëshortin dhe djalin. 69)Lulje



ta Shehu, bashkëshortin. 70)Naxhije Shehu, bashkëshortin dhe djalin. 71) Naxhije Shehu, djalin. 72)Hana Emrullahu, bashkëshortin dhe djalin. 73)Ziza Zylfiu, bashkëshortin dhe djalin. 74)Rrahime Zylfiu, bashkëshortin dhe djalin. 75) Zylfie Zylfiu, bashkëshortin dhe djalin. 76)Sabrie Batusha, bashkëshortin dhe djalin. 77) Zylfie Batusha, bashkëshortin. 78)Violeta Krasniqi, bashkëshortin dhe vjehrrin. 79)Azize Shehu, bashkëshortin dhe djalin. 80) Zepa Shehu, bashkëshortin dhe djalin. 81)Hyrisahe(Sadik) Shehu, djalin. 82)Lavdie Shehu, bashkëshortin. 83)Fetie Shehu, djalin. 84) Xhyzidie Batusha, djalin. 85)Hida-jete Asllani, bashkëshortin. 86)Behare Shehu, bashkëshortin. 87)Nexhmije Shehu, bashkëshortin. 88)Remzie Batusha, bashkëshortin. Ministre Snezana! Njihu me emrat kriminelëve serb që kryen masakrën në të dy Krushat dhe në fshatrat e Rahovecit në mars të vitit 1999 e ku skenat apokaliptike i pa i gjithë planeti? Në dosje kam të gjitha gjenialitetet. Po shënojmë vetëm emrat për lexuesit e gazetës.

1)SVETA TASIQ(police). 2)MOMCILO NIKOLIQ(police). 3)DIMITRIJA NIKOLIQ. 4)SAVA NIKOLIQ. 5)ZILATKO GJERGJEVIQ. 6) GJEOGRJE CVETKOVIC. 7) RANKO NIKOLIQ. 8)RANKO(CULI)PETKOVIC. 9)ZVEZDAN NIKOLIQ. 10)GORULUB (GORIC) GJERGJEVIQ. 11)RASHKO NIKOLIQ. 12)KRUNISLLAV NIKOLIQ. 13)DRAGOLUB NIKOLIQ. 14)NOVICA NIKOLIQ. 15)STANIMIR NIKOLIQ. 16) MILADIN NIKOLIQ. 17)VITKO NIKOLIQ. 18)RADE NIKOLIQ. 19)DANILLO NIKOLIQ. 20)BLLOGOJE(BAZHI) NIKOLIQ. 21)BOGULB NIKOLIQ. 22)GORAN NIKOLIQ. 23)BOBAN NIKOLIQ. 24)MILOSH NIKOLIQ. 25)SRECKO(KEKA)TASIQ. 26)DARKO TASIQ. 27)STAJKO(VUCE) PETKOVIC. 28)SASHA PETKOVIC. 29) DOJCILO PETKOVIC. 30)DOBRI PETKOVIC 31)PREDRAG(DRAGI) PETKOVIC. 32)BORISLAV CETKOVIC. 33)GORAN PETKOVIC. 34)NENAD PETKOVIC. 35)GOLLUB PETKOVIC. 36)DEJAN PETKOVIC. 37)MILOSH PETKOVIC. 38) STEVAN PETKOVIC. 39)GOROLUB(TRAJCE) CVETKOVIC. 40)MILADIN(MADA) GJERGJEVIC. 41)BOSHO GJERGJEVIC. 42)NEBJOSHA GJERGJEVIC. 43) SLLAVKO PETKOVIC. 44)JOVAN(GALLI) PETKOVIC. 45)ALEKSANDAR(GOCKI) PETKOVIC. 46)PERA STANKOVIC. 47)STANISLLAV(TANI)DIMITRIJE. 48) KRSTA NIKOLIQ. 49)DUSHKO NIKOLIQ. 50)NENAD NIKOLIQ. 51)BLLOGOJE NIKOLIQ. 52)CVETKO NIKOLIQ. 53)BAJRAM(rom) GASHI. 54)AGIM GASHI(rom). 55)LULZIM GASHI(rom). 56)JOVAN (JOVC) NIKOLIQ. 57)STANKO CVETKOVIC. 58)TOMCE CJEKTOVIC. 59)DRAGAN TOMIQ.

Shumë rrugë në Krushën e Madhe kujtojnë emrat e mallkuar të milicëve që qëlluan krushasit e pa mbrojtur. Sot krushasit thonë se në rrugën mbi Celinë hapi zjarr Miladin Nikoliq. Populli gjithçka e ka fiksuar. Edhe fëmijët i kanë mësuar emrat e milicëve serb që kryen masakrën e pashëmbullit. Në orët e masakrës së llatharëshme një burrë mer në duar djepin, ku e shoqja kishte lidhur djalin e vogël. Kur shtëpisë po i vihej flaka e zonja e shtëpisë u ndodh tek komshia. Dhe i shoqi mer djepin në duar dhe vrapon. Por në një udhë me gorrica militarët serb e vrasin krushasin, që kishte në duar djalin e vogël të lidhur në djep. Të nesërmen e shoqja, e cila po kërkonte burrin dhe djalin që e la në djep, dëgjon në udhën mbi vorreza të qara të një fëmije. Aty ajo gjen burrin e vrarë dhe fëmijën që qante. Djalin e ruante macja e shtëpisë me dy kotele të vogla.

Krimet e serbëve nuk i nxë asnjë enciklopedi. Hamleti thotë: - “O tmerr! - O tmerr! - O tmerr i patreguar!”

Shënim! Gjithçka që thuhet në këtë shkrim është e noterizuar pranë organeve kompetente në Kosovë

90 - VJETORI I DITËLINDJES



Mirënjohje për mësuesin, historianin dhe etnologun e shquar, nga Shoqatat "Labëria", "Sofra pukjane", "Eko Turizmi" Pukë dhe "Malziu"

PROF. XHEMAL MEÇI "NDERI DHE KRENARIA" E OBVL

Nga Sakip CAMI
Shkrimtar&poet

Bashkia Bukë, në bashkëpunim me Shoqatën "Sofra Pukjane" organizoi më 23 korrik 2026 në sallën e konferencave të Pallatit të Kulturës të këtojt qyteti, me madhështinë që meritonte, ceremoninë jubilarë kushtuar 90 -vjetorit të lindjes së Prof. Xhemal Meçi - "Mjeshtër i Madh", një figurë që ia kushtoi jetën historisë, kulturës, arsimit dhe identitetit të Pukës.

Ky jubile nuk ishte thjesht një përvjetor. Ishte një ditë reflektimi, respekti dhe mirënjohjeje për një jetë të ndërtuar mbi dijen, punën e palodhur, ndershmërinë dhe përkushtimin ndaj vendlindjes. Ishte ditë nderimi për njeriun që, përmes veprës së tij shkencore dhe njerëzore, la një trashëgimi të vyer për Pukën dhe për mbarë kulturën shqiptare.

Në këtë ceremoni të moderuar me mjeshtri të rrallë artistike nga nënkryetarja e Bashkisë Pukë, Denisa Meçi (njëherësh mbesa e Prof. Xhemalit) morën pjesë personalitete të jetës publike, akademike, kulturore, institucionale dhe sipërmarrëse, të cilët me praninë e tyre i dhanë edhe më shumë dinjitet kësaj dite të veçantë.

90 VJET DITURI, DINJITET DHE SHËRBIM NDAJ ATDHEUT

Në emër të Kryesisë së Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve, Sekretari i Përgjithshëm i saj Z.Halil Rama - Mjeshtër i Madh, shkrimtar & poet, kryeredaktor i gazetës "Veterani", në fjalën e tij paraqiti me profesionalizëm, kompetencë shkencore dhe ndjeshmëri, jetën, veprën dhe kontributin shumëdimensional të Prof. Xhemal Meçi. Përmes analizës së tij të thelluar, ai solli në vëmendje vlerat e jashtëzakonshme të profesorit si studiues, historian, etnograf, publicist dhe mbrojtës i palodhur i trashëgimisë kulturore të Pukës, duke dëshmuar edhe njëherë vendin e merituar, që ai zë në historinë dhe kulturën shqiptare. Në fund të fjalës ai ftoi nënkryetarin e kësaj organizate, Mjeshtër i Madh, Muharrem Gjoka (njëherësh dhe President i Ansambllit Artistik "Hazi Ndreu" - "Nderi i Kombit", për të akoruar Prof. Xhemal Meçi titullin "NDERI DHE KRENARIA E OBVL" me motivacionin: "Për kontributin e shquar si studiues, shkrimtar dhe publicist, i cili ka pasqyruar me së miri në faqet e gazetës VETERANI", historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Pukës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar".

Në këtë ditëlindje jubilarë, Prof. Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh", një figurë që ia kushtoi jetën historisë, kulturës, arsimit dhe identitetit të Pukës u vlerësua me Çertifikatë Mirënjohjeje edhe nga Shoqatat: "Labëria" (dega Tiranë), "Sofra pukjane", "Eko Turizmi" Pukë dhe "Malziu", të cilat ja dorëzuan kryetarët

përkatës: prof. asoc. dr. Zaho Golemi, Tonin Alia, Gjovalin Alia dhe Enver Shpata.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe depteti i Kuvendit të Shqipërisë z. Arjan Ndoj.

VEPRA E PROF. XHEMAL MEÇIT DO TË JETOJË PËRTEJ KOHËS


Kolonel Msc. Bilbil Dervishi, mik i veçantë i prof. Xhemalit dhe familjes Meçi - një ndër personalitetet e njohura për kontributin e tij evident në organet ligjzbatuese, gjatë përshëndetjes së tij, ndër të tjera tha se "Njerëzit e mëdhenj nuk maten vetëm me vitet e jetës, por me gjurmët që lënë në kujtesën e kombit. Profesor Xhemal Meçi është një prej atyre personaliteteve, vepra e të cilëve do të jetojë përtej kohës."

Me duartrokitje u prit nga qindra të pranishmit në këtë festë jubilarë fjalë e prof. dr. Bajram Xhafa, i cili ndër të tjera tha: "Ju i dashur prof. Xhemal Meçi, në këtë jetë nuk jeni një personazh kalimtar i zakonshëm. Jeni një fenomen shoqëror. Para jush çdokush vihet në vetgjykimë kritike për administrimin e jetës së vet. Jeta juaj gjithëkënd e nxit në refleksione të thella. Që në fëmijëri ju u udhëhoqët nga porositja e urtë apo deviza e Elez Hoxhës së Pukës kur paska lëshuar urtësinë: 'Ni gja që duhet ba, pse nuk mundesh me e ba siç duhet ba, mos e len pa baa, aq sa mundesh me e ba'. Dhe ju bëtë gjithçka të mirë ashtu siç duhet ba". Të pranishmit në këtë event mbresëlënëse, mes të cilëve edhe publicisti e shkrimtari i mirënjohur Sefer Pasha, mirëpritën dhe duartrokitën gjithashtu edhe fjalët përshëndetëse të znj. Sabrie Nushi, muzikologe, profesoreshë dhe autore e botimeve muzikore (kunata e profesor Xh.Meçit), si dhe të Znj. Samidije Lamaj, drejtore e Pallatit të Kulturës Pukë.

Mbrsëlënëse për pjesëmarrësit që gjithashtu fjalë e mirënjohjeje e nënkryetares së Bashkisë Pukë Denisa Meçi. Ajo e konsideroi fat të madh që ka patur në jetë, një gjysh që u nderua në 90-vjetorin e ditëlindjes. "Ne nipër e mbesa, kemi pasur privilegjin të rritemi pranë teje, që nuk ishte vetëm shtylla e familjes tonë, por edhe udhërrëfyesi ynë në jetë."

I dashur gjysh!

Ju na mëkuat me dashuri, urtësi dhe durim, duke na mësuar se vlerat më të



mëdha nuk fitohen me fjalë, por ndërtohen çdo ditë me shembullin personal. Na udhëzoje të ecim gjithmonë në rrugën e drejtë, të vendosim synime të ndershme dhe të mos heqim dorë kurrë nga puna e përkushtuar", tha mes emocioneve mbesa e tij, Denisa Meçi.

Vetë profesor Xhemal Meçi, si në mbyllje të eventit, edhe gjatë drekës entuziaiste që familja e tij shtroi në Turizmin e Pukës, falenderoi përzemërisht

pjesëmarrësit dhe shprehu angazhimin për të vazhduar ashtu si në nëntë dekada të jetës së tij të vrullshme e të suksesshme, edhe në vijim duke i vejë dijen, përvojën dhe përkushtimin e tij në shërbim të njerëzve, të historisë dhe të vendlindjes.